

**RAPORTI**  
**VJETOR PËR**  
**VITIN**  
**2019**

**FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR - MAQEDONI**

## **PËRMBAJTJA:**

Hyrja.....	3
Raporti i aktiviteteve të zbatuara në suazat e koncepteve në vitin 2019.....	4
Arritjet kryesore dhe/ose aktivitetet që e kanë shënuar punën e organizatave të mbështetura në suazat e fushave strategjike të FSHHM-së në vitin 2019.....	31
Lista e projekteve dhe grantistëve të mbështetur në vitin 2019.....	52

## HYRJA

Në periudhën 2019-2022, Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni (FSHHM) do të punojë në arritjen e tri qëllimeve strategjike: **1)** mbështetja e reformave lidhur me fushat prioritare në FSHHM (procesi i aderimit në BE, arsimit dhe të rinjtë, shëndetësia, korniza juridike dhe fiskale për shoqërinë qytetare dhe përforcimi juridik). FSHHM-ja do të sigurojë mbështetje për pjesëmarrjen e shoqërisë qytetare dhe do të kontribuojë në krijimin e politikave publike dhe aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve dhe sigurimin e njohurive praktike; **2)** kërkesa e llogaridhënies nga pushtetet, nëpërmjet ndjekjes së përparimit në raport me politikat publike lidhur me aderimin në BE, ndjekje e planifikimit dhe shpenzimit të mjeteve publike në arsimin e lartë dhe të lokacioneve buxhetore të cilat i afektojnë grupet e marginalizuara në shëndetësi, siç janë ndjekja e politikave të pushteteve lokale në fushat e planifikimit urbanistik, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe buxhetet lokale në tri komuna; dhe **3)** përmirësimi i cilësisë dhe qasjes të shërbimit shëndetësor, juridike dhe arsimore për bashkësitë të cilat kanë qasje të kufizuar të shërbimit apo marrin shërbime me cilësi jo të mirë.

Në vitin 2019, aktivitetet e planifikuara për arritjen e tri qëllimeve strategjike janë zbatuar në suazat e katër **koncepteve**: (1) Pjesëmarrja e shoqërisë qytetare në procesin e aderimit në BE; (2) Partneritetet në bashkësitë për përparimin e demokracisë lokale; (3) Arsimimi i bashkësive më të vogla etnike; dhe (4) Strategjia e rretëzimit për përforcimin juridik, dhe tri **fusha**: (1) Mjedis mundësues për shoqërinë qytetare; (2) Të drejtat studentore dhe angazhimi; dhe (3) Politikat shëndetësore të mbështetura në të drejtat.

Shuma e përgjithshme e mjeteve të shpenzuara për zbatimin e aktiviteteve të FSHHM-së në vitin 2019 është 252.775.434 denarë, prej të cilëve 234.492.852 denarë vijnë nga Fondacionet Shoqëria e Hapur, kurse 18.282.581 denarë nga donatorë të tjerë.

**Raporti i aktiviteteve të zbatuara në suazat e  
koncepteve në vitin 2019**

## KONCEPTI: Pjesëmarrja e shoqërisë qytetare në procesin e aderimit në BE

Koncepti *Pjesëmarrja e shoqërisë qytetare në procesin e aderimit në BE*, ka për qëllim ta mbështesë agjendën reformatore lidhur me qasjen në BE, dhe kjo në fushat e gjyqësorit, e luftës kundër korrupsionit dhe mbrojtjes nga diskriminimi, duke kontribuar kështu në evropeizmin e shoqërisë.

Qëllimet specifike të konceptit janë: (1) të përforcohet kapaciteti dhe të zmadhohen njohuritë e organizatave qytetare dhe të administratës për çështje që lidhen me strukturën institucionale të BE-së dhe me proceset kryesore politike, për procesin e negociatave, si edhe për të drejtën e BE-së në fushat e gjyqësorit, luftës kundër korrupsionit dhe parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi; (2) të mundësohet dialogu i strukturuar midis organizatave qeveritare dhe Qeverisë, si mekanizëm për krijim të politikave publike në fushat e gjyqësorit, luftës kundër korrupsionit dhe parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi; (3) të mbikëqyret procesi i tërësishëm për aderim në BE që të sigurohet se reformat i shërbejnë interesit publik dhe i kënaqin pritjet e qytetarëve; dhe (4) të zmadhohet qarkullimi i informacioneve dhe të përmirësohet kuptimi i qytetarëve mbi reformat që lidhen me aderimin në BE, duke i ndihmuar kështu që të bëjnë përzgjedhje të informuar dhe t'i mbështesin proceset reformatore për evropeizmin e shoqërisë.

Në përputhje me planin vjetor të aktiviteteve dhe buxhetit të miratuar, në vitin 2019 u realizuan një sërë aktivitete për arritjen e qëllimeve specifike, të cilat lidhen ngushtë midis tyre dhe plotësojnë njëri-tjetrin, dhe kjo nëpërmjet:

1) Skemës së granteve për tri rrjete të shoqatave dhe fondacioneve për ndjekje të pavarur të politikave publike në fushat e gjyqësorit, mbrojtjes nga diskriminimi dhe lufta kundër korrupsionit, e cila përfshiu:

- Mbështetjen për grupin *Bluprint për reforma në gjyqësor*, e përbërë nga: *Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë"*, *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut*, *Instituti për të Drejtat e Njeriut*, *Instituti për Politika Evropiane*, *Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj* dhe *Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike*, që e ndjekin zbatimin e Strategjisë për reforma në gjyqësor (2017-2022) dhe Planin aksionar (të Strategjisë). Kjo mbështetje ka rezultuar me përgatitjen dhe prezantimin e "Analizës për zbatim të Strategjisë për reforma në sektorin gjyqësor (2017-2020) për periudhën 2018-2019"<sup>1</sup>. Janë përgatitur edhe tri monitorim-brifingje për gazetarët nga procesi i

---

<sup>1</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2019/09/Analiza-na-sproveduvanje-na-Strategijata-za-reforma-na-pravosudniot-sektor-2017-2022.pdf>

ndjekjes së zbatimit të Strategjisë<sup>2</sup>, si dhe një dokument për politikat publike me temë "Procesi i vetingut në gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut"<sup>3</sup>.

- Mbështetjen për Platformën për Luftë kundër Korrupsionit nëpërmjet *Institutit për Demokraci "Societas civilis"*, që përgatiti dhe prezantoi tri dokumente për politikat publike: "Analiza e dispozitave të antikorrupsionit dhe rreziqeve të korrupsionit në Ligjin e ri për prokurimet publike"<sup>4</sup>, "Analiza e punës së KSHPK-së për vitin 2017 dhe rekomandimet për punën e KSHPK-së së re"<sup>5</sup> dhe studimi për politikat publike mbi efikasitetin e institucioneve antikorruptuese në ndjekjen e korrupsionit – "Pasqyrë krahasuese e efikasitetit dhe efektivitetet në punën e Prokurorisë Publike për Ndjekjen e Krimit dhe Korrupsionit të Organizuar dhe Prokurorisë Speciale Publike"<sup>6</sup>.
- Mbështetjen e *Koalicionit Margjina* i cili punon mbi përparimin e sistemit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, nëpërmjet zbatimit konsekuent të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi në përputhje me standardet evropiane. Është përgatitur dhe promovuar "Raporti i implementimit të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi 2011-2018"<sup>7</sup>.
- Mandej, me iniciativën e këtyre tri rrjeteve, kurse me mbështetje edhe nga rrjete të tjera shoqatash dhe fondacionesh të cilat bashkojnë qindra shoqata, fondacione dhe iniciativa, para Kuvendit të RMV-së u mbajt konferencë për shtyp dhe protestë me kërkesë drejtuar deputetëve në Kuvend që urgjentisht të zgjedhin dhe emërojnë kuadër udhëheqës në shumë institucione dhe trupa rregullatorë nëpërmjet Komisionit për Çështjet e Zgjedhjeve dhe Emërimeve<sup>8</sup>.

2) Mbështetjes së *Fondacionit për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis* për implementimin e projektit "Observatori për reforma mediatike"<sup>9</sup>, që ka për qëllim të kontribuojë në përmbushjen e Prioriteteve reformuese urgjente si parakusht për qasjen e RMV-së në BE, nëpërmjet identifikimit dhe heqjes së pengesave për zhvillimin demokratik të sektorit të mediave.

3) Grantit për *3a Evrotink – Qendra për Strategji Evropiane* për mbikëqyrjen e procesit të tërësishëm të aderimit në BE, që të sigurohet se reformat i shërbejnë interesit publik dhe i

---

<sup>2</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/press-release/prezentiran-prviot-monitoring-brif-za-sledene-na-reformite-vo-pravosudstvoto/>; <https://fosm.mk/press-release/graganskite-organizatsii-reakiraat-vazhnite-zakoni-se-nosat-na-netransparenten-nachin-i-so-delumna-vkluchenost-na-graganskiot-sektor/>; <https://fosm.mk/press-release/bluprint-grupa-donesenite-zakoni-se-dobra-osnova-za-promeni-potrebna-e-dosledna-implementatsija/>

<sup>3</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2019/12/veting-proczes-na-sudstvoto-vo-rsm.pdf>

<sup>4</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/01/analiza-tm-mkd.pdf>

<sup>5</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/01/analiza-dsk-mkd.pdf>

<sup>6</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/01/analiza-studija-mkd.pdf>

<sup>7</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/01/izvestaj-za-implementacija-na-zakonot-za-sprecuvanje-diskriminacija-2011-2018.pdf>

<sup>8</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/current-project/grashanskite-organizaczii-pobaraa-sobranieto-itno-da-ja-deblokira-rabotata-na-komisijata-za-izbori-i-imenuvana/>

<sup>9</sup>Gjendet në: <http://mediaobservatorium.mk/>

kënaqin pritjet e qytetarëve, si dhe për ndjekjen e shfrytëzimit të fondeve evropiane, që përfshiu:

- Përgatitjen dhe promovimin e "Analizës krahasuese së raporteve të Komisionit Evropian mbi përparimin e RM-së 2016-2019"<sup>10</sup>, nëpërmjet të cilës në mënyrë të ilustruar pasqyrohet përparimi i proceseve eurointegruese sipas kapitujve.
- Përgatitjen dhe promovimin e "Analizës së pjesëmarrjes maqedonase në Erasmus plus: Potenciale dhe kufizime"<sup>11</sup>, ku u analizua puna e Agjencisë Nacionale për Programe Arsimore Evropiane dhe Mobilitet dhe rezultatet e menaxhimit të saj me aksionet decentralizuese të Programit Erasmus plus në periudhën 2014-2018.
- Përgatitjen dhe prezantimin e katër "Ditarëve të aderimit"<sup>12</sup>, të cilët lidhen me procesin e aderimit të Maqedonisë së Veriut në BE, kurse nëpërmjet tyre u analizua puna e Qeverisë, zhvillimi i politikave evropiane, implementimi i Prioriteteve urgjente reformuese dhe dialogu i rregullt politik midis Maqedonisë së Veriut dhe BE-së.
- Përgatitjen e pesë sesioneve edukativo-debatuese, të a.q. EURO TALK, të organizuara sipas rregullit ÇETAMHAUS me ambasadorët e shteteve anëtare në BE dhe me ekspertë të tjerë të cilët punojnë në fushën e proceseve eurointegruese.
- Organizimin e "Shkollës për politika evropiane", shkollë dyditore, e cila u fokusua në ngjarjet, sfidat dhe narracionet në nivel evropian, kurse e determinojnë diskursin e zgjerimit në nivel të BE-së dhe ndikojnë mbi perceptimin e qytetarëve dhe faktorëve të shteteve anëtare në BE në raport me vendet kandidatë, si dhe drejt ndërtimit të strategjive efektive komunikuese me dy drejtime – drejt vendimmarrësve, por edhe drejt publikut.
- Zbatimin dhe prezantimin në publik të dy hulumtimeve anketues "Eurometar" mbi mendimet e qytetarëve për çështje që lidhen me eurointegrimet dhe besimin e tyre tek institucionet.

4) Bashkëpunimit me *Institutin për Politika Evropiane* nga Berlina janë organizuar pesë trajnime të specializuara me ligjërues ndërkombëtarë mbi tema që lidhen me integrimin në BE, përvojat rajonale dhe fushat specifike të Kapitullit 23 (gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe mbrojtja nga diskriminimi). Qëllimi themelor i këtyre trajnimeve ishte ndërtimi i kapaciteteve për përfaqësuesit e sektorit qytetar dhe të administratës publike mbi procesin e aderimit në BE. Në këto trajnime morën pjesë 176 persona, prej të cilëve 120 ishin përfaqësues nga shoqata dhe fondacione, kurse 56 ishin nëpunës administrativë nga 15 institucione qendrore në RMV.

---

<sup>10</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/current-project/prezentatsija-na-komparativnata-analiza-na-izveshtajte-na-evropejskata-komisija-datim-za-reformi/>

<sup>11</sup>Gjendet në: [https://fosm.mk/wp-content/uploads/2019/09/Analiza\\_Erazmus\\_ZA-WEB.pdf](https://fosm.mk/wp-content/uploads/2019/09/Analiza_Erazmus_ZA-WEB.pdf)

<sup>12</sup> Gjendet në: <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/01/zapis-7.pdf>;  
<https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/01/zapis-9.pdf>;  
<https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/01/accession-log-8-1.pdf>; dhe  
<https://fosm.mk/wp-content/uploads/2019/11/zapis10.pdf>

5) Skemës së granteve për shoqatat dhe fondacionet, me qëllim që të zmadhohet qarkullimi i informacioneve dhe që qytetarët të kuptojnë më mirë reformat që lidhen me aderimin në BE të Kapitullit 23, e cila përfshin:

- 15 grante për shoqata<sup>13</sup> për zbatimin e aktiviteteve të cilat do të kontribuojnë për kuptimin më të mirë të procesit të aderimit të RMV-së në BE.
- Përpilim të fushatës së mediave për vizualizim të gjetjeve të marra nga 15 grantet e dhëna që të përmirësohet kuptimi te qytetarët mbi reformat lidhur me aderimin në BE.

6) Ndjekjes së reformave në administratën publike që e zbaton FSHHM-ja nëpërmjet projektit **Aleanca Qytetare për transparencë – Mbikëqyrje e procesit të reformave në administratën publike nga organizatat qytetare**, që mbështetet nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet instrumentit financiar IPA për shoqërinë qytetare dhe Programit për mediat për vitin 2015, që përfshiu: :

- Përgatitjen e tri raporteve mbi shkallën e implementimit të Strategjisë për reforma në administratën publike 2018-2020, dhe kjo për periudhën shkurt-dhjetor 2018<sup>14</sup>, periudhën korrik-dhjetor 2018<sup>15</sup>, si dhe raportin e fundit ku janë prezantuar katër artikuj hulumtues gazetaresk të cilët përpunuan çështje lidhur me korrupsionin dhe qasjen te shërbimet<sup>16</sup>.
- Përgatitjen dhe prezantimin<sup>17</sup> e anketës hulumtuese “Qëndrimet e qytetarëve për punën e administratës publike”<sup>18</sup>.
- Përgatitjen e tri dokumenteve për politika publike “Drejt administratës përgjegjëse dhe transparente nëpërmjet institucioneve kontrolluese funksionale – Analiza mbi vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve kontrolluese”<sup>19</sup>; “Fuqia lëvizëse e negociatave: Roli i administratës publike në negociatat, e mbikëqyrur nëpërmjet grupeve të punës”<sup>20</sup> dhe “Analiza gjinore e sektorit publik në RMV me fokus të veçantë te gratë në pozita udhëheqëse”<sup>21</sup>.

---

<sup>13</sup>Gjendet në: <https://bit.ly/2wsX9da>

<sup>14</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2019/09/II-Izvestaj-RJA-FINAL-WEB.pdf>

<sup>15</sup>Gjendet në: [https://fosm.mk/wp-content/uploads/2019/12/foom\\_reforma-na-javnata-administracija-3-izvestaj.pdf](https://fosm.mk/wp-content/uploads/2019/12/foom_reforma-na-javnata-administracija-3-izvestaj.pdf)

<sup>16</sup> Gjendet në: <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2019/09/IV-Izvestaj-SRJA1.pdf>

<sup>17</sup> Gjendet në: <https://bit.ly/2xZPEed>

<sup>18</sup> Gjendet në: <https://bit.ly/2xmGpVx>

<sup>19</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/current-project/kon-odgovorna-i-transparentna-javna-administratsija-preku-funksionalni-kontrolni-institutsii/>

<sup>20</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/current-project/dvizhechkata-sila-na-pregovorite-ulogata-na-javnata-administratsija-vo-pregovorite-sogledana-niz-rabotnite-grupi/>

<sup>21</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/03/javna-politika-2.pdf>



- Përgatitjen dhe publikimin e gjashtë analizave<sup>22</sup> që bazohen në gjetjet e monitorimit të reformave të administratës publike, me fokus në administratën lokale. Analizat janë përgatitur për këto tema: kënaqësia nga cilësia e shërbimeve në nivel lokal, menaxhimi me financat publike, transparenca gjatë punësimit, nevojat teknike-teknologjike të institucioneve konkrete në sektorin publik dhe qasja te informacionet për personat me aftësi të kufizuara. Monitorimi ka përfshirë 25 komuna.
- Organizimin e konferencës përmbyllëse “Si mandej? Reformat në administratën publike pas Këshillit Evropian të Qershorit”, ku morën pjesë funksionarë qeveritarë, ambasadorë, përfaqësues të delegacionit të BE-së, organizata qytetare dhe gazetarë, të cilët dhanë pasqyrë mbi gjendjen, por edhe parashikimet për mundësitë dhe sfidat në reformën e administratës publike, sidomos pas Këshillit Evropian të qershorit.<sup>23</sup>

7) Shtesë, në suazat e konceptit po zbatohet edhe projekti **Mbështetja e Maqedonisë për integrimin në BE dhe NATO**, me mjete nga fondi rezervë i *Iniciativës Evropiane për Shoqëri të Hapur*, në bashkëpunim me *Institutin për Politika Evropiane në Shoqërinë e Hapur*. Konkretisht, projekti lidhet me mbështetjen institucionale të Zyrës së Ndërmjetësuesit, me angazhim të katër personave profesionalë.

8) Me mjetet nga fondi rezervë i *Iniciativës Evropiane për Shoqëri të Hapur*, kurse në bashkëpunim me *Institutin për Politika Evropiane në Shoqërinë e Hapur*, FSHHM po e zbaton projektin **Deri te shteti i robëruar - policia, gjyqësia dhe prokuroria publike**. FSHHM-ja vendosi bashkëpunim dhe i mbështeti *BIRN Maqedonia*, *Koalicionin “Të gjithë për Gjykim të Drejtë”*, *Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Institutin për të Drejtat e Njeriut* që të përgatisin publikim me titull “Deri te ‘shteti i robëruar’ në Maqedoninë e Veriut - policia, gjyqësia dhe prokuroria publike”. Ky publikim i analizon reformat dhe mënyrat se si ishte kryer robërimi politik i institucioneve në Maqedoninë e Veriut, që ndikoi mbi faktin që shteti të kategorizohet si ‘shtet i robëruar’. Rezultatet e marra janë prezantuar nëpërmjet gjashtë artikujve hulumtues gazetaresk të zbatuar nga gazetarët e *BIRN*, kurse janë plotësuar me analizë eksperte të gjendjeve në gjyqësor, prokurori publike dhe polici. Publikimi do të promovohet në vitin 2020, kur gjetjet dhe rekomandimet do të shkëmbehen me institucionet dhe organizatat shtetërore dhe ndërkombëtare.

9) FSHHM-ja, së bashku me programet për Amerikën Latine dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në *Fondacionet Shoqëria e Hapur*, kurse në bashkëpunim me *Topos Partnership*, filloi ta zbatojë Projektin **Ripërcaktimi i narracioneve të antikorrupsionit**. Qëllimi i kësaj iniciative është të identifikohen dhe zbatohen narracione efektive publike

<sup>22</sup>Gjendet në: <https://fosm.mk/current-project/novi-shest-analizi-od-monitoringot-na-reformata-na-javnata-administratsija-na-lokalno-nivo/>

<sup>23</sup> Gjendet në: <https://fosm.mk/current-project/reformite-na-javnata-administratsija-treba-da-prodolzhat-so-istoto-tempo-se-sproveduvaat-za-trajno-da-se-podobri-kvalitetot-na-zhivot-na-sekoj-graganin/>

të cilat do ta zbulojnë korrupsionin, por të cilat kultivojnë, njëkohësisht, pjesëmarrje qytetare, aksion dhe shpresë. Projekti përfshin studime krahasuese të rasteve në tri shtetet: Maqedonia e Veriut, Brazili dhe SHBA. Organizatat qytetare nga Maqedonia e Veriut të cilat marrin pjesë në këtë projekt janë: *Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE; Instituti për Demokraci “Societas Civilis”; Forumi Arsimor Rinor; Multikultura dhe Koalicioni “Të gjithë për Gjykim të Drejtë”*.

10) Gjithashtu, FSHHM-ja vendosi një zyrë të veçantë për projektin **Dialogu me organizatat qytetare – Platforma për pjesëmarrje të strukturuar në integrimet në BE**, i cili zbatohet në bashkëpunim me organizatat partnere *Qendra për Komunikime Qytetare, Reaktor – Hulumtime në Aksion dhe EuroTink – Qendra për Strategji Evropiane*. Projekti është mbështetur nga Bashkimi Evropian nëpërmjet instrumentit financiar IPA për shoqëri të hapur dhe Programit për mediat 2016-2017, dhe përfshiu:

- Përgatitjen dhe krijimin e një Platforme për pjesëmarrjen strukturore në integrimet në BE. Kjo ueb-platformë ([www.dijalogkoneu.mk](http://www.dijalogkoneu.mk)) shërben për shpërndarjen e centralizuar të informacioneve në lidhje me procesin e aderimit, dhe mbi të mund të gjenden informacione rreth punës dhe funksionalitetit të tre mekanizmave zyrtarë për bashkëpunim midis organizatave qytetare dhe institucioneve në RSM. Gjatë përgatitjes së ueb-platformës, është bërë hartëzimi i shoqatave dhe fondacioneve në RSM, që rezultoi me një bazë të dhënash me 2.096 shoqata dhe fondacione aktive.
- Mbajtjen e konferencës me temë “Përparimi i dialogut të strukturuar midis institucioneve dhe organizatave qytetare” ku është prezantuar Platforma për pjesëmarrje të strukturuar në integrimet në BE, si pikë qendrore për konsultim midis shoqatave dhe fondacioneve dhe institucioneve.
- Zhvillimin e “Metodologjisë për monitorim të punës dhe efekteve të grupeve sektoriale të punës” si dokument i cili e përkufizon qasjen për mbikëqyrje të funksionimit të grupeve sektoriale të punës dhe pjesëmarrjen e organizatave qytetare në punën e tyre.
- Mbikëqyrjen e shtatë takimeve të grupeve sektoriale të punës nga hulumtuesit e projektit. Njëkohësisht, është siguruar prania e hulumtuesve në mbledhjet e grupeve sektoriale të punës dhe themelimi i komiteteve sektoriale monitoruese. Janë mbajtur dhjetë mbledhje me përfaqësuesit e ministrive resurse përgjegjëse mbi punën e grupeve sektoriale të punës, kurse janë nënshkruar edhe gjashtë memorandume për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacioneve me ministrinë dhe sekretariatet kompetente <sup>24</sup>, me synim ndërtimin e dialogut të strukturuar.

---

<sup>24</sup>Sekretariati për Çështje Evropiane; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Drejtësisë; Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujërave.

- Është formuar rrjetë e nëpunësve administrativë, kurse bashkëpunimi përfshin shkëmbim të informacioneve për pjesëmarrjen e shoqatave dhe fondacioneve në punën e grupeve sektoriale të punës dhe përgatitjen e konsultimeve sektoriale me përfaqësues të shoqërisë qytetare.
- Janë përgatitur katër dokumente për politikën publike lidhur me aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE me temë: “Roli dhe rëndësia e grupeve sektoriale të punës në procesin e aderimit të Maqedonisë në BE”; “Përfshirja e grupit sektorial të punës për konkurrencë dhe inovacione”; “Roli dhe shkalla e pjesëmarrjes së organizatave qytetare në procesin e negociatave midis BE-së dhe Republikës së Serbisë”; dhe “Roli dhe shkalla e pjesëmarrjes së organizatave qytetare në negociatat midis BE-së dhe Republikës së Malit të Zi”.
- Përgatitjen dhe organizimin e dhjetë konsultimeve sektoriale midis organizatave qytetare dhe përfaqësuesve të ministrive, ku u diskutua mbi pjesëmarrjen e organizatave qytetare në punën e grupeve sektoriale dhe u përgatitën rekomandime për përparimin e procesit të pjesëmarrjes, Gjithashtu, ueb-platforma mundësoi promovim të indikatorëve për matjen e përparimit në zbatimin e politikave sektoriale nga institucionet kompetente, si dhe organizim të takimeve me organizatat qytetare.
- Është zbatuar dokumentim dhe shpjegim i dy seancave të mbajtura nga Këshilli për Bashkëpunim me Shoqërinë Qytetare dhe Zhvillim të Shoqërisë Qytetare<sup>25</sup>. Në ueb-platformën ([www.dijalogkoneu.mk](http://www.dijalogkoneu.mk)) janë arkivuar agjendat dhe procesverbalet dhe lajmërimet për seancat e Këshillit.

Si pjesë e aktiviteteve operative, FSHHM-ka e mbështeti financiarisht dhe nga ana e ekspertizës përgatitjen e Strategjisë për transparencë të Qeverisë së RMS-së me Planin aksionar (2019-2021). Mandej, përfaqësues të FSHHM-së morën pjesë në: grupin e punës për përgatitje të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik; grupin e punës për përgatitjen e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe përplasjes së interesave; aktivitetet përfaqësuese për vendosjen e modelit për përfshirjen e organizatave qytetare në strukturën negociuese të shtetit me BE-në; dhe përgatitjen e Strategjisë nacionale parandalim të korrupsionit dhe përplasjes së interesave 2020-2024 me Plan aksionar. .

### **Vendosja e Rrjetës së Organizatave Qytetare për Partneritet të Hapur Qeveritar (PHQ) dhe Këshillit Nacional për PHQ**

Në dhjetor të vitit 2019 me mbështetje nga Sekretariati i Iniciativës Ndërkombëtare Partneritet për Pushtete të Hapura, kurse në bashkëpunim me Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, FSHHM-ja filloi me aktivitetet për vendosjen rrjetës së

<sup>25</sup>Gjendet në: <https://dijalogkoneu.mk/ЦСО-Дијалог/совет-за-соработка-со-граѓански-цента/седници/?link=sednici>

organizatave qytetare për Partneritet të hapur qeveritar (PHQ) dhe Këshill Nacional për PHQ.

Qëllimi është krijimi i strukturës për konsultime dhe për koordinim në suazat e shoqërisë qytetare dhe midis pushteteve, organizatave qytetare, qytetarëve dhe palëve të tjera të prekura në procesin e dizajnit, zbatimit, mbështetjes, promovimit dhe monitorimit të prioriteteve dhe të iniciativave të PHQ-së në prag të përgatitjes së planit të ri nacional aksionar.

Që zmadhohet pjesëmarrja e shoqërisë qytetare në proceset e PHQ-së, në përgatitjen e këtij plani aksionar dhe për mbështetje, nxitje dhe monitorim të zbatimit të planit në vijim dhe planeve të ardhshme, do të vendosen mekanizma të qartë, të strukturuar dhe të qëndrueshëm për dialogun permanent midis shoqërisë qytetare dhe pushteteve. Struktura e re duhet ta mbindërtojë praktikën e përhershme dhe resurset e angazhuara dhe përfshin krijim të rrjetës së organizatave qytetare për përfshirjen në proceset e PHQ-së dhe për formimin e strukturës/trupit nacionale ose të a.q. Këshill për PHQ, me numër të barabartë të përfaqësuesve nga institucionet (në nivel të lartë) dhe nga organizatat qytetare. Këshilli do të koordinojë dhe monitorojë procesin e përgatitjes dhe zbatimit të planit nacional aksionar.

Në dhjetor 2019, u organizua një takim inicial, ku ishin ftuar organizatat qytetare që marrin pjesë në grupet ekzistuese të punës për PHQ. Pas takimit, u formua Këshilli Iniciale (KI) për vendosjen e rrjetës së organizatave qytetare, të cilin e përbëjnë 10 organizata qytetare. Në takimin e parë të KI-së, u shqyrtua dhe u miratua draft-dokumentet për rrjetën (struktura dhe parimet, thirrja dhe formulari i anëtarësimit) dhe u publikua thirrja për anëtarësim në këtë rrjetë. Përveç 10 anëtarëve të KI-së, për pjesëmarrje në këtë rrjet kanë aplikuar gjithsej 54 organizata. Rrjeta do të punojë për të inkurajuar, mbështetur dhe monitoruar autoritetet dhe institucionet me qëllim që të rritet transparenca dhe llogaridhënia e tyre dhe të sigurohen mundësi për pjesëmarrje aktive të shoqërisë qytetare.

Është përgatitur edhe drafti i parë model për krijimin e Këshillit për PHQ (si një organ nacional ose i ashtuquajtur forumi i të gjithë palëve të prekura) për koordinim dhe monitorim të zhvillimit dhe zbatimit të planeve nacionale aksionare, duke iu referuar nevojës, qëllimeve, objektivave, përbërjes/anëtarëve, mënyrës së zgjedhjes, rolit dhe përgjegjësisë. Më 24 dhjetor 2019, u mbajt një takim fillestar konsultues i KI-së me përfaqësuesit e institucioneve që janë përfshirë në proceset e PHQ deri më tani, ku u shqyrtua draft-modeli dhe u dhanë rekomandime për përmirësim.

Në fillim të vitit 2020, do të mbahet një asamble themeluese e rrjetës, ku do të ftohen edhe organizata ndërkombëtare. Në shkurt të vitit 2020, nëpërmjet një procesi këshillues, dokumentet për Këshillin pritet që të finalizohen dokumentet për këshillin dhe do të shpallet një thirrje për pjesëmarrje në këtë organ (për organizatat qytetare) dhe do të emërohen përfaqësues të institucioneve, kështu trupi do të bëhet funksional.

## KONCEPTI: PARTNERITETE NË BASHKËSI PËR PËRPARIM TË DEMOKRACISË LOKALE

Koncepti *Partneritete në bashkësi për përparim të demokracisë lokale* i mbështet përpjekjet e përbashkëta të aktorëve të organizatave lokale të shkaktojnë ndryshime sistematike në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësore, planifikimin urban dhe shpenzimin e parave në tri komuna – Manastir, Tetovë dhe Shtip.

Qëllimi i parë specifik i konceptit është përforsimi i bashkësive të pafavorizuara në mënyrë që ato të mund të përfshihen në procese konsultative në mjediset e tyre lokale, në drejtim të dizajnit të zgjidhjeve në politikat që do t'i pasqyrojnë nevojat e tyre prioritare.

Në bashkëpunim me anëtarët e Ekipit Maqedonas për Aktivizëm Kreativ, i cili vepron në kuadër të Qendrës për Arte Bashkëkohore, nëpërmjet mbledhjes dhe analizës së të dhënave me hulumtim të synuar desktop, si dhe me intervista të strukturuar gjatë vizitave dhe bisedave me palët e prekura në terren është përgatitur analizë e detajuar e gjendjes dhe nevojave specifike në secilën nga tri komunat. Në përputhje me gjetjet e hulumtimeve, nën mentorim të Qendrës për Aktivizëm Artistik nga Nju Jorku, kurse në suazat e metodologjisë për aktivizëm kreativ, Ekipi Maqedonas për Aktivizëm Kreativ e adaptoi kurrikulën për angazhim kreativ në bashkësi. Në çdo komunë u konsultuan bërthama lokale aktiviste, kurse pastaj (në bazë të kurrikulës) janë zbatuar një sërë punëtorish dhe ligjëratah. Duke i shfrytëzuar njohuritë dhe shkathtësitë e reja të fituara, grupet lokale, me mbështetje nga Ekipi Maqedonas për Aktivizëm Kreativ, nëpërmjet procese pjesëmarrëse dizajnuan aksione urbane që janë zbatuar në të tri komunat.

Në Tetovë u zbatuan katër aksione urbane. Figura e personazhit të famshëm vizatimor La Linea ishte vendosur pranë lokalitetit Banjë, për të paralajmëruar për vrimën e rrezikshme në rrugën që ekziston atje prej tre vjetësh. Për shkak të rrëshqitjes së parregulluar të tokës, vrima në rrugë po zgjerohet vazhdimisht dhe në rast të reshjeve më të dendura është një kërcënim serioz për sigurinë e kalimtarëve dhe banorëve të këtij vendi. Në fillim të shtatorit, u krye aksioni i dytë, me titull "Mirë se vini në Tetovë, qyteti ku askush nuk interesohet për asgjë"<sup>26</sup>. Në vende të dukshme nëpër të gjithë qytetin, aktivistët vendosën tabela dhe paralajmëruan përsëri për sasinë e madhe të mbeturinave të shpërndara nëpër qytet, për gropat e parregulluara nëpër rrugë, kaosin e trafikut, nevojën për transport publik etj. Me aksionin "Mbështetje"<sup>27</sup>, aktivistët nga Tetova bënë thirrje për zgjidhjen e problemit me rrëshqitjen e tokës dhe me murin mbështetës të parregulluar në rrugën për në Banjë. Me aksionin "Kujdes!!! Nuk ka semafor!" aktivistët u bënë thirrje publikisht institucioneve të komunës që të ndërmarrin urgjentisht masat e domosdoshme për rregullimin e trafikut dhe për vendosjen në

<sup>26</sup><https://fosm.mk/current-project/dobredojdovte-vo-tetovo-gradot-vo-koj-nikomu-ne-mu-e-gajle-za-nishto/>

<sup>27</sup><https://fosm.mk/current-project/umetnichka-akcija-potpورا/>

përdorim të semaforëve në udhëkryqin para Universitetit të Tetovës dhe Shkollës së Mesme së Mjekësisë "Nikolla Shtejn".

Bërthama lokale në Shtip bëri katër aksione të përqendruara në problemet në rritje me planifikimin urban në qytet. Me aksionin e parë në një vrimë në asfalt para shkollës fillore lokale, e cila ka ekzistuar për një kohë të gjatë dhe pas shiut mbushej me ujë, ishin vendosur disa rosat plastike. "Familja e rosave" arriti t'i ndalojë automobilat të mos kalojnë mbi gropë dhe kështu t'i lagin kalimtarët, pra nxënësit. Me aksionin "Kërkohej Thor nga planeti Azgard", aktivistët u bënë thirrje autoriteteve që të riparojnë vendet problematike në bulevardin përpara shkollës dhe të instalojnë sinjalizim të përshtatshëm, i cili do të risë sigurinë në trafik. "Thor hedh mbeturinat në kosh, kurse në Azgard ka kosha për mbeturina" është aksioni i cili u bëri apel institucioneve kompetente që të vendosin kosha të reja për mbeturina në shtegun rekreativ, kurse nga banorët e Shtipit kërkuan që të sillen si duhet me mjedisin jetësor. Aksioni "Mirës se vini në Shtip, qytetin pa banja publike dhe kulturë publike!" edhe njëherë u thekua nevoja për vendosjen në përdorim të banjës publike të qytetit. Njëkohësisht, aktivistët u bënë thirrje bashkëqytetarëve që t'i kushtojnë më shumë vëmendje kulturës dhe higjienës publike dhe të sillen me përgjegjësi ndaj qytetit të tyre. Për më tepër, si pjesë e Festivalit të Punëtorëve të Tekstileve, anëtarët e bërthamës së aktivistëve lokalë vendosën një gjilpërë të madhe si një monument ose simbol të industrisë së tekstilit dhe punëtorëve të tekstilit. Aksionet i motivuan institucionet kompetente lokale të reagojnë dhe të zgjidhin disa nga problemet e treguara.

Grupi lokal në Manastir zbatoi katër aksione. Me aksionin "Ky nuk është parkim" për një mëngjes, në lokacionet më të frekuentuara në qytet u shënuan me tullumbace të verdha. Aktivistët e aktualizuan mosgjdhjen e problemeve me parkimin në qytet, që kontribuon në lëvizje të kufizuar dhe kështu zvogëlon sigurinë e të gjithë pjesëmarrësve në trafik. Aksioni i dytë "Thuaju reve, Manastiri po vdes<sup>28</sup> theksoi një nga problemet më të hidhura për Manastirin – ndotjen e ajrit. Në fillim të dimrit, në nëntor ishte zbatuar edhe aksioni i radhës i titulluar "Po vjen dimri, a do të marrim frymë". Shenja të dukshme të radiacionit ishin vendosur në rrethqarkullimet në Manastir me qëllim që të theksojnë domosdoshmërinë e gjetjes së domosdoshme urgjente të zgjidhjeve për zvogëlim të ndotjes në Manastir, Rrugëve në Manastir iu vendosën emra të rinj satirikë, që flasin për problemet me rrugët.

Ekipi Maqedonas për Aktivizëm Kreativ, mbajti takime të rregullta për koordinim midis tyre, por edhe takime virtuale me *Qendrën për Aktivizëm Artiski* nga Nju Jorku. Në tetor u mbajt edhe takimi i punës së grupeve lokale me *Qendrën për Aktivizëm Artistik* nga Nju Jorku dhe Ekipin Maqedonas për Aktivizëm Kreativ, duke përfunduar kështu faza e parë e trajnimit të tyre. Pas trajnimit, anëtarëve të këtyre grupeve u është dërguar thirrje për dhënien e granteve dhe ato, në bashkëpunim me Ekipin Maqedonas për Aktivizëm

---

<sup>28</sup><https://fosm.mk/current-project/kazhete-im-na-oblastite-bitola-umira/>

Kreativ, i zhvilluan planet e veta vjetore për aksione nëpërmjet të cilave do të ndërmjetësojnë për zgjidhjen e problemeve në bashkësinë e tyre duke përdorur metodologjinë e aktivizmit kreativ. Janë dhënë tri grante për organizimin dhe lehtësimin e proceseve këshilluese gjithëpërfshirëse në bashkësitë, të cilat duhet të rezultojnë me procese për zhvillimin dhe implementimin e ideve të projektit, si vijon: bërthama lokale e aktivistëve në Manastir, për projektin "Manastiri kreativ"; bërthama lokale e aktivistëve në Tetovë, për projektin "Revolucioni i heshtur" dhe bërthama lokale e aktivistëve në Shtip, për projektin "Krijimi / aksioni për zhvillimin e demokracisë".

Më 21 dhjetor të vitit 2019, në bashkëpunim me Qendrën për Arte Bashkëkohore dhe Fondacionin IDEA Evropa Juglindore u organizua konferenca "JO KËSHITU (NUK) BËN! Për aktivizmin kreativ dhe ambicieve të ndikohet mbi ndryshimet Për aktivizmin kreativ dhe ambiciet për të ndikuar mbi ndryshimet shoqërore"<sup>29</sup>, ku më shumë se 100 aktivistë dhe teoricienë nga vendi dhe disa vende të rajonit ndanë përvojat, mendimet, mësimet e nxjerra, praktikat e mira, por edhe ide interesante për shfrytëzimin e potencialit të aktivizmit krijues për ndryshime shoqërore. Ngjarja ofroi gjithashtu një përpjekje fillestare për të pasqyruar në mënyrë sistematike hapësirën aktiviste të shtetit, në mënyrë që jo vetëm të lokalizohen aktorët dhe format e veprimit, por edhe të dallohen korniza ideologjike, strategjike dhe përvojat taktike, si dhe të shënohen dhe analizohen faktorët e suksesit të këtyre angazhimeve.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (Komiteti i Helsinkit) vazhdoi të kryejë monitorim të rregullt të narracioneve ekstreme nacionaliste në të tri rajonet (Manastir, Shtip dhe Tetovë). Gjetjet e monitorimit dhe analizat u ofruan për diskutim publik në mënyrë që të nxitet debati për gjetjen e mënyrave efektive për të trajtuar dhe adresuar sfidat e gjuhës së urrejtjes. Bashkëpunimi midis FSHHM dhe Komitetit të Helsinkit për monitorimin e narracioneve ekstreme nacionaliste vazhdon edhe në 12 muajt e ardhshëm.

Në bashkëpunim me Programin e Shkëmbimit të Arteve në Fondacionet e Shoqërisë së Hapur në Nju Jork, mbështetje institucionale iu mundësua edhe Qendrës për Arte Bashkëkohore në Shkup për periudhën 2019-2022, kurse në bashkëpunim me Iniciativën e Shoqërisë së Hapur Evropiane, iu dha një grant Kontrapunktit për të mbështetur pjesëmarrjen e të ftuarve nga rajoni në seancën e ardhshme të festivalit "KRIK" në vitin 2020. FSHHM-ja mbështeti Shoqatën "Iniciativa e Zhvillimit Ekonomik të Romëve" - REDI Tetovë në aksionin e tyre për të dhuruar fonde për familjet rome të prekura nga tërmeti në Shqipëri.

Ekipi i konceptit e monitoroi vazhdimisht zbatimin e granteve dhe siguroi konsultime dhe mentorime në përputhje me nevojat specifike të identifikuar, si dhe konsultime për përgatitjen e raporteve narrative dhe financiare mbi grantet e dhëna.

---

<sup>29</sup><https://fosm.mk/event/konferenczija-vaka-ne-biva/>



Qëllimi i dytë specifik i konceptit *Partneritete në bashkësi për promovimin e demokracisë lokale* është mbështetja e përpjekjeve të intensifikuara të përbashkëta të aktorëve qytetarë për të monitoruar dhe përfaqësimin në drejtim të përmirësimit të politikave dhe praktikave në fushat e mbrojtjes së mjedisit jetësor, planifikimit urban dhe shpenzimit të parave publike.

U organizuan dy trajnime për përfaqësuesit e organizatave qytetare që kanë kapacitet të kryejnë monitorim dhe përfaqësim në fushat e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe shpenzimit të parave publike. Trajnimi i parë për përforcimin e kapaciteteve të organizatave lokale për të punuar mbi çështje që lidhen me mbrojtjen e mjedisit jetësor, i zbatuar nga Qendra për Hulumtime dhe informim mbi mjedisin jetësor Eko-vetëdije nga Shkupi, morën pjesë 10 përfaqësues të organizatave qytetare nga rajonet e Tetovës, Shtipit dhe Manastirit. Pjesëmarrësit e përzgjedhur morën pjesë në mënyrë aktive në trajnimin i cili ishte dizajnuar në mënyrë interaktive me qëllim që të inkurajohen pjesëmarrësit të largohen nga zonat e tyre komforte dhe t'u përgjigjen kërkesave të ushtrimeve të parapara gjatë trajnimit. Trajnimi për monitorimin e shpenzimit të parave publike është realizuar nga Qendra për Komunikime Qytetare nga Shkupi për 15 përfaqësues të 8 organizatave qytetare nga Manastiri, Shtipi dhe Tetova. Trajnimi mundësoi zgjerimin dhe thellimin e njohurive në fushën e aftësive hulumtuese dhe monitoruese dhe i njohu pjesëmarrësit me Ligjin e ri për prokurimet publike. Pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë mbi mënyrat për analizim të tenderëve të ekspozuar nga mediat, të shqyrtojnë dhe kërkojnë Sistemin elektronik të prokurimeve publike, kurse biseduan edhe për rreziqet dhe pasojat e korrupsionit në prokurimet publike.

Në fillim të qershorit, FSHHM-ja shpalli një thirrje për dhënie të grante për organizatat qytetare lokale dhe/ose rrjetet e angazhuara në monitorimin dhe përfaqësimin e politikave dhe praktikave të pushteteve lokale në Manastir, Tetovë dhe Shtip në fushat e mbrojtjes së mjedisit jetësor, shpenzimit të parave publike dhe planifikimit urban. Janë dhënë 10 grante<sup>30</sup> për monitorimin dhe përfaqësim të politikave dhe praktikave të pushteteve lokale në Manastir, Tetovë dhe Shtip.

### **Strategjia nacionale për zhvillim të konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2020 - 2022)**

Gjatë vitit 2019, FSHHM-ja dha kontributin e vet në përgatitjen e Strategjisë nacionale për zhvillim të konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2020 - 2022), me pjesëmarrje aktive të përfaqësuesve të saj në klasterët tematikë për arsimin, kulturën, të rinjtë, inkluzionin social dhe vetëqeverisjen lokale, si edhe me përfshirjen në trupin e koordinativ multidisiplinor për zhvillim të Strategjisë. Njëkohësisht FSHHM-ja siguroi edhe mbështetje financiare për angazhim të

---

<sup>30</sup><https://fosm.mk/current-project/dodeleni-10-granta-na-lokalni-graganski-organizatsii-i-mrezhi/>



ekipit të përbërë nga shtatë ekspertë për përgatitje të analizave të klasterëve për zhvillim të Strategjisë.

Në formën e vet finale, analizat përfshijnë: vlerësim të gjendjes; analizë të kornizës së politikave publike; institucionet/faktorët kryesorë dhe veprimin e tyre; analizë të fushës së veprimit dhe të shërbimeve që i dërgojnë; analizë të palëve të prekura; analizë të mjedisit rrethues (i brendshëm dhe i jashtëm); dhe përfundim mbi gjendjen/sfidat. Mandej një ekspert ka punuar në harmonizimin e tekstit final të Strategjisë, e cila në nëntor të viti 2019 është miratuar nga Qeveria e RMS-së.

Përveç përgatitjes së analizave, ekspertët morën pjesë edhe në konsultimet dhe finalizimin e Draft-strategjisë, duke përfshirë edhe planet aksionare sipas fushave tematike, prioriteteve dhe qëllimeve të përcaktuara në këtë Strategji, si dhe masat dhe instrumentet që dolën nga proceset konsultative. Gjithashtu, përfaqësuesit e FSHHM-së dhe ekspertët e angazhuar dhanë kontribut profesional në takimet konsultuese dhe evenimentet publike, si dhe në konferencën ndërkombëtare që u mbajt në tetor të vitit 2019.

### **Bërthamat rajonale kreative**

Në suazat e *Iniciativës të antikorrupsionit për bashkëpunim të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur*, Projekti **Bërthamat kreative rajonale: shfrytëzimi i fuqisë së artit dhe kulturës për nxitje të aksionit qytetar kundër korrupsionit** zbatohet në rajonet e Afrikës Perëndimore dhe Ballkanit Perëndimor nga viti 2019 deri në vitin 2021. Qëllimi i përgjithshëm i iniciativës është të mbështesë artistët, ndërmjetësuesit dhe gazetarët që të jenë më efektivë në përpjekjet e tyre për të rritur interesin e qytetarëve për çështje që lidhen me korrupsionin në mjediset e tyre. Bërthamat kreative rajonale janë platforma virtuale ku pjesëmarrësit përpiqen të mësojnë se *si* dhe *pse* të angazhohen në mënyrë kreative në çështjet e antikorrupsionit me qëllim që të ndryshohet perceptimi i publikut, por edhe të ndikohet mbi politikën publike. Në këtë projekt përfshihen katër fondacionet nacionale nga Ballkani Perëndimor (Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia) dhe Fondacioni Rajonal i Afrikës Perëndimore (IOOZA). FSHHM-ja dhe IOOZA-ja kanë rolin të lehtësojnë koordinimin, komunikimin dhe bashkëpunimin midis pjesëmarrësve në këtë iniciativë.

Në prill, në Beograd është organizuar takimi i parë i përfaqësuesve të fondacioneve të përfshira në këtë projekt, ku u bisedua detajisht mbi aktivitetet e parapara në këtë projekt dhe u punua në harmonizimin e kornizës kohore për zbatimin e tyre, si dhe për përgjegjësitë e mëvetëshme të secilës prej palëve të përfshira. Janë identifikuar edhe nevojat për mjete shtesë në buxhet. Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues të Qendrës për aktivizëm artistik nga Nju Jorku dhe nga Programi për shkëmbim të arteve nga Nju Jorku. Takimi i dytë për këtë iniciativë u mbajt në dhjetor në Dakar, Senegal, kurse nikoqirë ishin kolegët nga Afrika Perëndimore. Palët e përfshira në projekt mbajnë takime të rregullta virtuale për përgatitjen e aktiviteteve dhe për zbatimin e tyre.

FSHHM-ja shpalli thirrje ndërkombëtare për përzgjedhje të organizatës partner për mësim në suazat e kësaj iniciative, e cila do të dizajnojë metodologjinë dhe do të zbatojë evaluim të jashtëm të projektit, nëpërmjet identifikimit të treguesve relevantë, arritjeve kryesore, sfidave dhe mësimet e nxjerra.

Trajnimi i parë rajonal për artistët, aktivistët dhe gazetarët e interesuar nga shtetet e Ballkanit Perëndimor u mbajt në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, nga 14 deri më 19 tetor 2019. Trajnimin me titull “Akademia për aksion artistik” e zbatoi Qendra për aktivizëm artistik nga Nju Jorku, në bashkëpunim me Ekipin Maqedonas për Aktivizëm Kreativ në Qendrën për Arte Bashkëkohore nga Shkupi. Gjithsej 20 pjesëmarrës në trajnim (5 nga secili nga vendet e Ballkanit Perëndimor të përfshirë në iniciativë) patën mundësinë të njihen me metodologjinë e aktivizmit kreativ dhe nëpërmjet formave artistike të krijojnë zgjidhje të tyre për problemet e identifikuara që lidhen me mbizotërimin e korrupsionit. Trajnimi përfundoi me zbatimin e aksionit kreativ “Mos jep Ryshfet, mos jep o qejfli”<sup>31</sup>, të cilin pjesëmarrësit në akademi e zbatuan në qendër të Sarajevës. Për habinë e pjesëmarrësve, edhe përkrah pritjeve të vogla, megjithatë në afat prej tri orësh në shëtitoren në Sarajevë u mbledhën mbi 50 rrëfime për korrupsion nga qytetarët.

Pas përfundimit të trajnimit, çdo fondacion që mori pjesë në iniciativë shpalli një thirrje të synuar për grante të vogla. Në këtë thirrje mund të paraqiteshin artistët, aktivistët dhe gazetarët që kanë përfunduar me sukses trajnimin dhe për të ofruar sugjerime për aktivitete mësimore se si të angazhohet publik i ri nëpërmjet të cilit do të testohet metodologjia dhe do të aplikohen njohuritë e marra në këtë trajnim. Aksioni kreativ i propozuar (ose seria e aktiviteteve) duhet të jetë aksion i cili do të ndikojë mbi të kuptuarit e publikut për luftën kundër korrupsionit. FSHHM-ja mbështeti pesë propozimet e pjesëmarrësve nga Maqedonia me grante të vogla, si vijon: Darko Taleski për aksionin Kreativ “Parada e korrupsionit”; Dragana Gunin për aksionin kreativ “Thuaji JO korrupsionit në fakultete”; Zorica Zafirovska për aksionin kreativ “Oksigjen!”; Igor Ilievski për aksionin kreativ “Tunde gjykatësin”; dhe Jelmaž Dervishi për aksionin Kreativ “Dita e hapur e kundër korrupsionit”. Për të gjitha projektet e pranuar do të sigurohet mentorim dhe konsultime me trajnuesit e Akademisë për aksion artistik. Trajnimi i dytë rajonal, “Akademia e aksionit artistik”, u mbajt në dhjetor në Dakar, Senegal, dhe në të morën pjesë 20 artistë, aktivistë dhe gazetarë nga Gana, Senegali dhe Guineja.

## **KONCEPTI: ARSIMI I BASHKËSIVE MË TË VOGLA ETNIKE**

Në përputhje me përcaktimet strategjike për vitin 2019, FSHHM-ja filloi zbatimin e konceptit *Arsimi i bashkësive më të vogla etnike*, i cili ka për qëllim të kontribuojë në ngritjen e cilësisë në arsimimin në gjuhën e bashkësive etnike më të vogla (gjuha turke,

---

<sup>31</sup>[https://www.youtube.com/watch?time\\_continue=10&v=9qWYtJrYSA](https://www.youtube.com/watch?time_continue=10&v=9qWYtJrYSA)

serbe, boshnjake). Nëpërmjet mbështetjes së drejtpërdrejtë të dhjetë shkollave rurale me mësim në gjuhën e bashkësive më të vogla etnike, koncepti drejtohet kah përmirësimin të kompetencave të arsimtarëve dhe pasurimin e resurseve mësimore dhe resurseve të tjera edukative (pajisja teknike, librat shkollorë dhe ndihmësit shkollorë, botimeve për lexim jashtë klase, materialeve didaktike dhe materialeve të tjera në gjuhën në të cilën mbahet mësimi) si dhe kah dizajnimin të politikave arsimore dhe zgjidhjeve të qëndrueshme sistematike të cilat do të mundësojnë mundësi të barabarta arsimore për të gjithë nxënësit.

FSHHM-ja e zbaton këtë koncept në partneritet me Drejtorinë për Zhvillim të Arsimit në Gjuhët e Bashkësive më të Vogla Etnike (Drejtoria) në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Byronë për Zhvillim të Arsimit (BZHA), kurse në bashkëpunim të ngushtë me organizatat partnere *Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore "Hap pas hapi"* dhe *Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis*.

Në këtë koncept përfshihen dy shkolla fillore me mësim në gjuhën boshnjake (SHFR "Dituria" nga fshati Ljubin, Komuna e Sarajit; dhe SHFK "Rajko Zinzifov" fsh. Orizari, Komuna e Velesit), tri shkolla me mësim në gjuhën serbe (SHFK "Shën. Kirili dhe Metodij" fshati Kuçevishtë, Komuna e Çuçer Sandevës; SHFK "Svetozar Markoviq" fshati Staro Nagoriçan, Komuna e Staro Nagoriçanit; dhe SHFK "Braça Ribar" fshati Tabanovc, Komuna e Kumanovës), katër shkolla me mësim në gjuhën turke (SHFK "Nexhi Zekirija" fshati Koxhaxhik, Komuna Qendër Zhupa; SHFK "Goce Delçev" Fshati Vasilevë, Komuna e Vasilevës; SHFK "Mustafa Qemal Atatürk", fshati Koliçani i Poshtëm, Komuna e Studeniçanit dhe SHFK "Strasho Pinxhur", fshati Karbinci, Komuna e Karbincit dhe SHFK "Vëllezërit Ramiz dhe Hamid" nga Komuna e Shuto Orizarit, e cila ka numrin më të madh të nxënësve që ndjekin lëndën zgjedhore *Gjuha dhe kultura e romëve*. FSHHM-ja nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me këto shkolla.

Qëllimi i parë specifik i konceptit *Arsimi i bashkësive më të vogla etnike* është mbështetje e drejtpërdrejtë e dhjetë shkollave rurale me mësim në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike.

Në fokusin e punës sonë për vitin 2019 ishin trajnimet për përfundimin e kapaciteteve të arsimtarëve, si një nga aktivitetet kryesore në këtë koncept. Kjo u zbatua në partneritet me Fondacionin *"Hap pas hapi"* dhe BZHA-në.

*Fondacioni "Hap pas hapi"* i rishqyrtoi dhe i rinovoi materialet për trajnim në përputhje me trendet bashkëkohore në mësimdhënie dhe mësim dhe në përputhje me nevojat janë shkëmbyer me shkollat që në vizitat e para. Të gjitha materialet e përgatitura janë përkthyer në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike (gjuhën boshnjake, serbe dhe turke).

Nga 24 deri më 27 qershor të vitit 2019 në Strugë u mbajt trajnimi "Praktika cilësore pedagogjike në shekullin e 21" ku morën pjesë 73 arsimtarë të ciklit fillor nga shkollat në

projekt. Ata patën mundësi të njihen me parimet mbi të cilat duhet të bazohet realizimi i mësimdhënies bashkëkohore, me strategjitë dhe teknikat për të mësuar të cilat nxitin kërkshërinë, hulumtimin, mendimin kritik dhe bashkëpunimin për interaksion midis të rriturve dhe fëmijëve, inkluzion, respektim të dallimeve dhe demokracisë për çdo fëmijë dhe për familjen e tij, si edhe krijimin e mjedisit për të mësuar dhe për zhvillim të vazhdueshëm profesional. Në të njëjtën periudhë në Ohër u mbajt edhe trajnimi “Nëpërmjet shkrim-leximit të mendimi kritik” ku morën pjesë 81 arsimtarë lëndorë dhe përfaqësues të shërbimeve profesionale të shkollave në projekt. Qëllimi i këtij trajnimi ishte aftësimi i arsimtarëve për mësimdhënie ku nxënësit do të zhvillojnë aftësitë për mendim kritik, zgjidhje të problemeve, diskutim të argumentuar dhe mësim kooperativ. Ky trajnim ishte siguruar edhe për 29 arsimtarë të tjerë nga shkolla të ndryshme filllore në shtet, të cilat e japin lëndën zgjedhore *Gjuha dhe kultura e vllahve, Gjuha dhe kultura e boshnjakëve* si dhe *Gjuha dhe kultura e romëve*.

Nga 18 deri më 21 dhe nga 21 deri më 24 gusht 2019 në Ohër u mbajt trajnimi “Arsimi për drejtësi sociale” ku morën pjesë 144 arsimtarë nga dhjetë shkollat e projektit. Nëpërmjet tri tërësive të cilat u përpunuan gjatë trajnimit (emërimi, shpallja dhe ndërtimi i aleancave, ata patën mundësi të njihen me konceptin e të drejtës sociale, të kuptojnë rëndësinë e respektimit të dallimeve midis njerëzve, të kuptojnë cila është baza psikike-sociale për krijimin e paragjykimeve dhe stereotipave, që nënkupton diskriminim dhe çfarë duhet të ndërmerret që të tejkalohen këto dukuri.

Që të sigurohet se arsimtarët i zbatojnë konceptet e përvetësuara, si dhe njohuritë dhe shkathtësitë të cilat i fituan në trajnime, në shkollat dhe në klasat, dhe në punën me nxënësit e vet, FSHHM-ja nëpërmjet edukatorëve të *Fondacionit “Hap pas hapi”*, siguroi ndihmë të vazhdueshme për arsimtarët, nëpërmjet vizitave dhe vendosjes së bashkësive për mësim në të gjitha dhjetë shkollat e projektit. Si formë inovative e zhvillimit profesional, bashkësia për të mësuar i mundëson çdo arsimtari të punojë në përmirësimin e praktikës së vet të përditshme, nëpërmjet punës së pavarur dhe hulumtimit, si dhe nëpërmjet diskutimeve me kolegët. Qëllimi i këtyre bashkësive për të mësuar është krijimi i kulturës për të mësuar në shkollë, përkatësisht arsimtarët të ndërmarrin aksion për përmirësim të punës së vet, duke krijuar sisteme efikase për reflektim dhe dokumentim të procesit profesional zhvillimor. Procesin e të mësuarit në secilën bashkësi e udhëheq mentori i emëruar nga projekti, i cili i udhëheq anëtarët e bashkësisë për të mësuar sipas metodologjisë së arsimtarëve liderë të Universitetit për Arsimin nga Kembrixhi, të përshtatur me kushtet tona. Gjatë vitit 2019 u realizuan 30 takime mentorësh gjithsej, nga tri takime për çdo shkollë në projekt. Në takimin e parë të mentorëve morën pjesë 129 arsimtarë, në të dytin 127 arsimtarë, kurse në takimin e tretë 116 arsimtarë. Janë nxitur dhe mbajtur pesë evenimente të rjetës, të cilat nëpërmjet vizitave të ndërsjella (shkollë nikoqire dhe shkollës mysafir) mundësuan bashkëpunim të përfortuar dhe shkëmbim të praktikave të mira mësimore për mësimdhënie dhe për të mësuar midis shkollave të projektit.

“Biblioteka me rrota” plot me libra me ilustrime, libra dhe materiale edukative, realizoi tri vizita në këto shkolla, që u mundësuan nxënësve të shoqërohen me aktorë, të lexojnë së bashku libra me ilustrime në gjuhën turke, boshnjake, serbe dhe maqedonase, të bisedojnë mbi tema dhe mbi përmbajtjet e librave me ilustrime dhe të argëtohen. Biblioteka me rrota ishte vizituar nga mbi 2.000 nxënës, prindër dhe arsimtarë, të cilët morën pjesë me kënaqësi në këto aktivitete. Për shumicën e fëmijëve, ky ishte kontakti i parë me bibliotekën dhe literaturën në gjuhën e vet amtare. Qëllimi i kësaj iniciative është nxitja e dashurisë për librat dhe interesin për të lexuar te fëmijët.

“Drejtësia sociale për arsimin cilësor” ishte tema e këtij viti në evenimentin tradicional *Speech 4 Teach*, të mbajtur më 19 dhjetor 2019 në Qendrën Kulturore Rinore në Shkup, ku shtatë arsimtarë, praktikues, përfaqësues të organizatave qytetare dhe profesorë mbajtën fjalime frymëzuese dhe shkëmbyen tregimet dhe pikëpamjet e tyre personale, sfidat me të cilat përballen në mjediset ku ata punojnë dhe veprojnë, por edhe pikëpamjet e tyre mbi mundësitë për tejkalimin e tyre.

Me qëllim që të nxitet krijimi dhe shpërndarja e resurseve arsimore në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike, organizata partnere *Metamorfozis* mbajtën një trajtim të shkurtër për Resurse të hapura arsimore (RHA), për arsimtarët e ciklit të ulët dhe arsimtarët lëndorë nga shkollat në projekt, ku arsimtarët u njohën me konceptet themelore të RHA-së, me rëndësinë e tyre për procesin arsimor, si dhe me fitimet për arsimtarët dhe për vetë nxënësit nga përdorimi i tyre. Gjithashtu, arsimtarëve u janë prezantuar edhe metodat dhe mjetet për krijim pa pagesë të RHA-së dhe ata patën mundësi, nëpërmjet punëtorisë praktike nën mentorim të ekipit të *Metamorfozis*, filluan menjëherë me krijimin e përmbajtjeve dhe me vendosjen e tyre onlajn. Njëkohësisht, u vendos përsëri dhe u riorganizua ueb-faqja [www.oer.mk](http://www.oer.mk).

FSHHM-ja siguroi materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse në përputhje me nevojat dhe kërkesat e shkollave (pajisje për kabinetet për shkencat e natyrës, për fizikën, kiminë, biologjinë, gjeografinë, rekuizita sportive, instrumente muzikore etj.) duke u pasuruar kështu resurset për mësimdhënie dhe për të mësuar në këto dhjetë shkolla në projekt, kurse arsimtarëve iu mundësua ta zbatojnë më lehtë dhe më me cilësi atë që e kanë mësuar në trajnimet në mësimdhënie. FSHHM-ja i siguroi edhe titujt e obliguar për botimet për lexime jashtë klase në gjuhën turke dhe serbe, si edhe librat jashtëshkollorë në gjuhën maqedonase për SHFK “Vllezërit Ramiz dhe Hamid” në Komunën e Shuto Orizarit.

Puna me fëmijët në paralelet e kombinuara u përcaktua si sfidë nga arsimtarët në mjediset më të vogla rurale, sidomos në shkollat rajonale me numër të vogël nxënësish. Në bazë të sfidave dhe nevojave të detektuara të shkollave në projekt, kurse në bazë të Memorandumit për bashkëpunim të nënshkruar nga FSHHM-ja me BZHA-në, Byroja përgatiti “Udhëzues mbi punën edukativo-arsimore në paralelet e kombinuara në

arsimin fillor". Ky udhëzues do të jetë bazë për trajtim të arsimtarëve nga këto shkolla të cilët punojnë në paralele të kombinuar në mjediset rurale.

Qëllimi i dytë specifik i konceptit *Arsimi i bashkësive më të vogla etnike* është puna me pushtetet arsimore në dizajnimin e politikave arsimore dhe zgjidhjeve të qëndrueshme sistematike të cilat do të mundësojnë mundësi të barabarta arsimore për të gjithë nxënësit.

Në suazat e qëllimit të dytë specifik, përfaqësuesit e FSHHM-së morën pjesë në disa grupe pune për krijimin e dokumenteve strategjike dhe/ose për revizion dhe përcaktim të planeve aksionare. Në periudhën shkurt-maj, FSHHM-ja mori pjesë në krijimin e prioritetëve, qëllimeve dhe aktiviteteve në suazat e Strategjisë nacionale për zhvillim të konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në klasterin për arsim dhe klasterin për të rinjtë. Mandej, FSHHM-ja zgjodhi përfaqësues në komitetin monitorues sektorial në Programin aksionar vjetor 2017, me fokus fushën e arsimit, ku mori pjesë aktivisht në punën e indikatorëve për Programin e rishqyrtuar për reforma në punësim dhe politikën sociale (ESPR 2022). Njëkohësisht, FSHHM-ja dha inputin e vet për indikatorët për *Kornizën për vlerësim të efektit* për arsimin, punësimin dhe politikën sociale në RMV.

Në bashkëpunim me *Fondacionin "Hap pas hapi"*, FSHHM-ja dorëzoi komente dhe propozime në pjesën e përparimit të zhvillimit profesional dhe të karrierës për kuadrin mësimdhënës në Draft-ligjin për arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme, i cili është miratuar nga mesi i vitit 2019.

Për shkak të implementimit të aktiviteteve ekzistuese, por edhe për planifikim të iniciativave për përparim të mësimdhënies në bashkësitë më të vogla etnike, FSHHM-ja bëri analizë të dokumenteve relevante nacionale strategjike, me qëllim që të përcaktojë rregullimin dhe vendin e arsimit në gjuhën e bashkësive më të vogla etnike (turq, serbë, boshnjakë, vllah dhe romë) si dhe të kultivohet gjuha dhe kultura e bashkësisë, përkatësisht realizimi i masave: a) mësimdhënie në gjuhën e bashkësive më të vogla etnike; dhe b) lëndë zgjedhore *Gjuha dhe kultura* (e përfaqësuesve të bashkësive më të vogla etnike). Qëllimi i kësaj analize është të kontrollohet: vendosja e masave për arsimim të përfaqësuesve të bashkësive më të vogla etnike në gjuhën e bashkësisë në dokumentet shtetërore strategjike; gjendja aktuale në realizimin e mësimdhënies në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike në RMV; gjendja aktuale në realizimin e lëndës *Gjuha dhe kultura*; pengesat dhe vështirësitë eventuale në realizimin e qëllimeve të këtyre masave; dhe perspektivat e këtyre masave. Në përgjithësi, në bazë të kësaj analize mund të përfundohet se, në nivel të politikave, këto çështje nuk analizohen dhe se mungon mbështetja themelore e arsimit cilësor në gjuhën e bashkësive më të vogla etnike, por edhe se mbledhja e të dhënave të veçuara në bazë etnike është sfidë serioze me të cilën rrezikohet mundësia për vlerësim valid dhe relevant i cilësisë dhe efikasitetit të masave për arsimin e përfaqësuesve të bashkësive

më të vogla etnike dhe lëndës *Gjuha dhe kultura*. Kjo analizë do t'u jepet institucioneve relevante (MASH, BZHA, Drejtorisë, komunave dhe shkollave në projekt) dhe do të gjendet në ueb-faqen e FSHHM-së.

Me mbështetjen financiare të *Programit rrjetë për mbështetje të arsimit të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur, FSHHM-ja i dha grant Shoqatës së Analistëve dhe Hulumtuesve të Rinj (SHAHR) nga Shkupi*, me qëllim që të përpilojë dhe pilotojë "Metodologji për rishpërndarje të mjeteve komunale për shkollat fillore" në komunat ku zbatohet koncepti *Arsimi i bashkësive më të vogla etnike*, përkatësisht, Saraj, Karbinci, Veles, Çuçer Sandevo, Staro Nagoriçan, Komanovë, Qendër Zhupë, Vasilevë, Studeniçan dhe Shuto Orizari. Nëpërmjet analizës krahasuese dhe asaj në terren, ky hulumtim ka për qëllim të ofrojë vlerësim paraelemineues për renovimet e nevojshme dhe investimet e reja në komunat e hulumtuara; të zmadhohet hapja dhe qasja e pushtetit lokal për nevojat e faktorëve lokalë dhe të zhvillohet metodologjia për alokim të qëndrueshëm dhe racional të mjeteve financiare për shkollat në komunat e hulumtuara. Analiza në terren ka filluar në vitin 2019, duke mbledhur të dhëna me ndihmën e mjetit për qasje të hapur tek informacionet me karakter publik në të dhjetë komunat dhe duke krijuar pyetësorë për anketimin e drejtorëve dhe arsimtarëve në shkolla. Pritet që gjetjet dhe analiza e plotë e hulumtimit, së bashku me rekomandimet për masat e ardhshme, të prezantohen para palëve të interesuara dhe para publikut në maj të vitit 2020.

FSHHM-ja, me ndihmë financiare *Programit rrjetë për mbështetje të arsimit të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur*, i dha grant Shoqatës së Drejtorëve të Shkollave dhe Internateve "LIDERË SHKOLLORË" na Shkupi, me qëllim që të përfordhet roli i shoqatës si palë e prekur pa përfshirjen e së cilës nuk do të duhet të përcaktohen politikat arsimore në shtet nëpërmjet mbështetjes për zhvillim të strategjisë shumëvjeçare të veprimit të shoqatës e cila përfshin komunikim strategjik dhe plan aksionar.

Qëllimi i tretë specifik i konceptit *Arsimi për bashkësitë më të vogla etnike* është mbështetja dhe inkluzioni i romëve në arsim.

Si vijim i përpjekjeve të veta shumëvjeçare dhe përcaktimit strategjik për inkluzion të romëve në të gjitha sferat e shoqërisë, FSHHM-ja e dizajnoi dhe filloi me zbatimin e projektit trevjeçar **Rregullisht në orë: aksion për përfshirje të romëve në arsimin fillor**, i financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti u zbatua së bashku me Shoqatën Qendra për Mbështetje Arsimore "Dendo vas" dhe me Fondacionin për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore "Hap pas hapi", në partneritet me MASH-in.

Projekti parashikon 1545 bursa për minimum 615 fëmijë në mbarë shtetin të regjistruar në ciklin e parë të arsimit fillor (315 bursa do të jepen në vitin 2019/2020; 615 në vitin 2020/2021 dhe 615 në vitin 2021/2022), punë të drejtpërdrejtë me bashkësinë romë mbi rëndësinë dhe për efektet nga vijimi i rregullt i shkollës mbi arritjet e fëmijëve, mbi arsimin

dhe jetën e tyre, trajnime të arsimtarëve dhe grante më të vogla shkollore për krijim të mjedisit inkluziv për të mësuar dhe punë në pesëdhjetë shkolla në mbarë shtetin. Nëpërmjet zvogëlimit të peshës financiare lidhur me shkollimin e fëmijëve nga familjet më të lëndueshme romë, projekti do ta zmadhojë përfshirjen dhe do ta zvogëlojë rrallimin e romëve në arsimin fillor, do të kontribuojë për vijimin e rregullt të mësimin dhe kalimin me sukses në klasat e tjera.

Në drejtim të sigurimit të mbështetjes shtesë të fëmijëve romë, FSHHM-ja i dha dy grante shoqatës *Qendra Informativë Afariste Romë në Maqedoni*. Me grantin e parë u mundësua përpilimi i programit për “Ndhmës pedagogjik për fëmijët në arsimin tetëvjeçar”, sipas profilin të përcaktuar me klasifikimin e profesioneve me vendim të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në përputhje me MASH-in. Granti i dytë është dhënë që të pilotohet programi nëpërmjet trajnimit të grupit të ndihmësve pedagogjikë në kohëzgjatje prej 190 orësh gjatë tre muajve, ku kandidatët e paraqitur në nivel teorik dhe nëpërmjet punës praktike trajnohen dhe japin provim përfundimtar i cili i ndihmon të marrin certifikatë për ndihmës pedagogjik për nxënësit në shkollën fillore.

Nga fundi i vitit 2019, FSHHM-ja i dha grant *Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve*, të cilin 13 vjet e mban Qendra Ditore për Fëmijë nga Rruga në Shuto Orizar dhe i cili punon për zvogëlim të qëndrimit të fëmijëve në rrugë. Mbështetja nga FSHHM-ja do ta ndihmojë Qendrën që të vazhdojë të kujdeset për 62 fëmijë në moshë nga 4 deri në 18 vjet të cilët janë jashtë sistemit arsimor, si dhe 38 fëmijëve të tjerë nga familjet e të kthyerve të cilëve u është siguruar ndihmë në veshje, mjete higjienike, materiale shkollore, si dhe mbështetje psikike-sociale dhe mbështetje për bërjen e detyrave të shtëpisë.

Deri në fund të shtatorit të vitit 2019, FSHHM-ja i administroi bursat për të rinjtë romë të cilët studiojnë mjekësi dhe programe të tjera studimore në suazat e programit RMUSP dhe RHSP, të financuara nga *Fondi Arsimor Rom*.

## **KONCEPTI: STRATEGJIA RRJETË PËR FORCIM LIGJOR**

Në vitin 2019 FSHHM-ja hyri në fazën përfunduese të *Iniciativës katërvjeçare globale për forcim ligjor të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur*. Qëllimi ynë i përgjithshëm në suazat e *Strategjisë rrjetë për forcim ligjor* është zhvillimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore për përforsim juridik të cilat në nivel lokal dhe nacional, do të mundësojnë qasje të drejtësia për të varfrit dhe grupet e marginalizuara të qytetarëve (romët, punëtorët/punëtoret seksuale, personat të cilët përdorin drogë, tekstilistët).

Tri qëllimet specifike të *Strategjisë rrjetë për forcim ligjor* përfshijnë aktivitete për: (1) institucionalizim të përforsimit juridik nëpërmjet zhvillimit të politikave nacionale dhe lokale për përforsim juridik, në bashkëpunim me të gjitha palët e prekura – përfaqësuesit e institucioneve nacionale dhe lokale, bashkësia akademike, shoqatat



qytetare dhe përfaqësuesit e grupeve të prekura të qytetarëve; (2) sigurim i qëndrueshmërisë së formave të ndryshme të qasjes te drejtësia; dhe (3) sigurim i dërgimit të vazhduar të shërbimeve cilësore juridike dhe të përforcimit juridik të të varfërve dhe grupeve të marginalizura të qytetarëve (romët, punëtorët/punëtoret seksuale, personat të cilët përdorin drogë, tekstilistët). Nëpërmjet punës së përbashkët të përfaqësuesve nga institucionet relevante nacionale dhe lokale, bashkësisë akademike, shoqatave qytetare dhe përfaqësuesve të grupeve të prekura të qytetarëve, FSHHM-ja synon përparimin e mundësive për institucionalizim dhe qëndrueshmëri të formave të ndryshme të qasjes te drejtësia, të bazuara në bashkësi.

Në suazat e qëllimit të parë specifik për institucionalizim të përforcimit juridik, u realizuan disa aktivitete për përfaqësim për:

- Zbatim të vazhduar të dy synimeve në fushën e drejtësisë, nga Plani i katërt aksionar nacional (PAN) për Partneritet të Qeverisë së Hapur 2018-2020 (PQH). Në bashkëpunim me dy ministri të cilat janë kompetente për zbatimin e synimeve, Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), përfaqësuesit e FSHHM-së morën pjesë në realizimin e aktiviteteve. Zbatimi i aktiviteteve për të dy synimet kontribuuan në zbatimin e qasjes te drejtësia, por edhe, në përgjithësi, për promovim të sundimit të së drejtës në nivel nacional dhe ndërkombëtar.
- Me qëllim që të njihen me konceptin për qasje te drejtësia dhe përforcimi juridik dhe në këtë mënyrë të marrin pjesë si duhet në realizimin e aktiviteteve të synimeve, u mbajtën dy seminare për të punësuarit në të dy ministritë. Seminari i parë, për përfaqësuesit e MPPS-së dhe Qendrave për Punë Sociale, u përgatit në bashkëpunim midis përfaqësuesve të FSHHM-së, MPPS-së, MD-së, organizatave qytetare partnere dhe klinikës juridike. Seminari i dytë për përfaqësuesit e MD-së dhe njësitë rajonale të MD-së që janë kompetente për sigurim të ndihmës juridike pa pagesë (NJP), u përgatit në bashkëpunim me MD-në dhe përfaqësuesit e projektit të Këshillit të Evropës për ndihmë juridike pa pagesë.
- Në nivel të institucionalizimit sektorial të përforcimit juridik, MPPS-ja e përfshiu qasjen te drejtësia në një spektër të gjerë të shërbimeve sociale, Nëpërmjet sistematizimit të ri, qendrat e mëparshme informative rrome kaluan një njësi organizative në 13 qendrat komunale për punë sociale, ku do të angazhohen juristë të trajnuar. FSHHM-ja do të sigurojë trajnim për juristët të cilët do të përfshijnë fusha ku qytetarët ballafaqohen më shpesh me probleme juridike.
- Në nivel lokal, në dy komuna – Shuto Orizari dhe Prilep – nëpërmjet bashkëpunimit të organizatave qytetare dhe pushteteve komunale u formuan qendra për qasje te drejtësia për romët dhe grupet e tjera të lëndueshme sociale. Përveç kësaj, në përputhje me Strategjinë nacionale për romët, në 12 komuna me numër të theksuar të bashkësisë rrome, këshillat komunalë miratuan plane operative për përforcim

juridik, si pjesë përbërëse e planeve lokale aksionare për integrim të Romëve. Për zbatimin përkatës së politikave lokale dhe për njohje më të mirë me konceptin e përforcimit juridik, u realizuan punëtori dhe takim pune me përfaqësuesit e këshillave të komunave. Në gjashtë komuna u përgatitën prioritetet e përbashkëta të grupeve aksionare lokale dhe të përfaqësuesve për vitin 2019-2020.

- Me mbështetje të FSHHM-së, Ministra e Punës dhe Politikës Sociale mori pjesë në Samitin Global për Partneritetin e Hapur Qeveritar, që u mbajt nga 29 deri më 31 maji 2019 në Otava, Kanada, ku prezantoi modelin maqedonas të institucionalizimit sektorial të përforcimit juridik. Në të njëjtin eveniment, FSHHM-ja i prezantoi përvojat maqedonase mbi përfshirjen dhe rëndësinë e qasjes te drejtësia, si një nga prioritetet për arritjen e qëllimeve në suazat e PHQ-së.
- Përfaqësuesit e FSHHM-së, shoqatat të cilat punojnë në qasje te drejtësia dhe zëvendësministri i drejtësisë morën pjesë në Forumin Botëror për Drejtësi, që u mbajt nga 29 prilli deri më 2 maj 2019 në Hagë, Holandë, ku janë prezantuar përvojat tona në fushën e përforcimit juridik.
- Shfrytëzimi i PHQ-së si platformë për përfaqësimin ndërkombëtar dhe në vend, mundësoi përfaqësuesit e FSHHM-së t'i prezantojnë përvojat dhe arritjet në dy evenimente të rëndësishme: në Forumin Botëror për Drejtësi në Hagë, Holandë, të përmendur më lart, si dhe në Takimin rajonal për shkëmbim të përvojave për PHQ, që u mbajt nga 3 deri 4 tetor 2019 në Budvë, Mali i Zi.
- Në tetor 2019 filloi të zbatohet Ligji i ri për ndihmë juridike pa pagesë (LNJP), i cili është rezultat i bashkëpunimit midis MD-së, FSHHM-së, *Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj* dhe pesë shoqatave të tjera të autorizuara për sigurim të ndihmës primare juridike. Pritet që zgjidhjet e përmirësuara në këtë Ligj do të kontribuojnë që të zmadhohet spektri i qytetarëve të cilët do të kërkojnë dhe do të fitojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore, që të përshpejtohet procedura e paraparë si urgjente dhe të sigurohet qëndrueshmëri të shoqatave të autorizuara. Pas miratimit të Ligjit, FSHHM-ja mori pjesë aktivisht në krijimin e akteve juridike nënligjore me të cilat rregullohet zbatimi përkatës i Ligjit.
- Përveç ligjit të ri LNJP, FSHHM-ja – drejtpërdrejt ose nëpërmjet mbështetjes së organizatave qytetare – mori pjesë aktivisht në përfaqësimin dhe në krijimin e shumë ligjeve të cilat janë relevante për përforcimin juridik, siç janë: Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, Ligji për marrëdhënie pune, Ligji për mbrojtje sociale, Ligji për mbrojtje shëndetësore, përfaqësim u përqendruar në qëllimin 16.3 në legjislacionin nacional, si dhe në krijimin e dokumentit për politikë publike për ndryshime të kornizës ligjore dhe të politikave të cilat do të ndikojnë kulturën probone.

- Mbështetja që FSHHM-ja ua jep organizatave qytetare të cilat punojnë në përparimin e gjendjes së romëve, mundësoi realizim të shtatë takimeve për përfaqësim në nivel lokal dhe një takim në nivel qendror me Kabinetin e ministrit pa resor, i obliguar për zbatimin e Strategjisë për përmirësim të statusit të romëve. Si rezultat i përfaqësimit të vazhdueshëm në nivel lokal, për t'u shënuar është përforsimi i bashkësisë romë në komunat Dellçevë, Berovë, Pehçevë dhe Vinicë, ku në vitin e parë të zbatimit të Programit për punë shoqërore të dobishme ishin angazhuar 43 rom të cilët janë përdorues të masës së re sociale – periudhë minimale e garantuar.
- Si rezultat i 22 takimeve individuale me avokatë, është përgatitur raport mbi gjendjen e përgjithshme në Maqedoni në lidhje me ndihmën juridike *probone*, përkatësisht mënyrën se si ofrohet kjo në zyra të ndryshme avokatie, përqindja e përfaqësimit të lëndëve të veçanta në një zyrë avokatie, mbajtja e evidencës së veçantë për lëndët *probone*, si dhe për mënyrën e tatimit të këtyre lëndëve.
- Është përpiluar doracak për vendosjen dhe mbajtjen e programit *probono* në suaza e punës shoqatave të avokatëve dhe të zyrave individuale të avokatëve.

Përpjekjet për arritjen e qëllimit të dytë specifik të *Strategjisë së rrjetës për forcim juridik* për sigurimin e qëndrueshmërisë së formave të ndryshme të qasjes te drejtësia janë në drejtim të:

- Ndryshimeve në ligjin e ri LPPJ në drejtim të vendosjes së skemës së granteve nëpërmjet së cilës shoqatat që sigurojnë ndihmë juridike primare do të sigurojnë qëndrueshmëri për këtë lloj shërbimesh;
- Përfshirjes së parajuristëve nga Qendrat informative romë në Qendrat për punë sociale, për funksionimin e të cilave sigurohen mjete nga buxheti i MPPS-së;
- Mbështetjes së nëntë organizatave për zbatim të aktiviteteve për financim inovativ, të cilat realizuan ankande, evenimente sportive, takime me bashkësinë e biznesit, evenimente publike dhe fushata nëpërmjet të cilave siguruan mjete financiare, shërbime dhe pajisje me të cilat mbulohet një pjesë e shërbimeve juridike që i sigurojnë këto organizata; dhe
- Realizimit të trajnimit gjithëpërfshirës për sipërmarrje sociale, të shoqëruar me mentorim individual shumë mujor të dhjetë organizatave qytetare.

Qëllimi i tretë specifik i *Strategjisë së rrjetës për forcim juridik* për sigurim të dërgimit të vazhdueshëm të shërbimeve juridike cilësore dhe përforsimin e të varfërve dhe grupeve të marginalizura të qytetarëve (romët, punëtorët/punëtoret seksuale, personat të cilët përdorin drogë, tekstilistët/tekstilistët), realizohet me mbështetje të 15

organizatave qytetare <sup>32</sup> për sigurim të shërbimeve juridike nëpërmjet katër formave të qasjes të drejtësisë të bazuara në bashkësi: ndihma parajuridike; ndihma juridike në bashkësi; ndihma juridike pa pagesë sipas LNJP-së; dhe klinika juridike për grupet e lëndueshme. Prej këndej, gjatë vitit 2019 janë realizuar këto aktivitete:

- Është siguruar ndihmë juridike dhe parajuridike për mbi 2,971 romë në 12 bashkësi romë në lidhje me: të drejtat e pacientëve; diskriminim; pagimin e paligjshëm të shërbimeve shëndetësore; sigurimet shëndetësore dhe sociale; dokumentacionin personal; ndihmë sociale; ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër; shëndeti riprodhues; imunizimi, etj. Përveç kësaj, parajuristët e trajnuar, nëpërmjet vizitave në terren në 12 komuna, sigurojnë informacion sistematik mbi të drejtat dhe mundësitë për të siguruar ndihmë parajuridike, të identifikojnë çështje ligjore dhe të monitorojnë vazhdimisht shkeljet individuale të të drejtave të njeriut. Është ngritur një ankesë individuale kundër shtetit përpara Komisionit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi të grave romë për qasje në gjinekolog. Janë mbajtur një numër i madh punëtorish edukative për rreth 379 qytetarë romë mbi temat e mëposhtme: imunizimi; të drejtat e pacientit; sigurimet shëndetësore dhe sociale; kujdesi shëndetësor dhe kontrollet shëndetësore falas; programet për mbrojtje shëndetësore parandaluese; shëndeti i grave; shërbime nga shërbimet e patronazhit; qasja falas tek informacionet me karakter publik, etj.
- Në Shuto Orizari është realizuar forum qytetar ku morën pjesë 25 përfaqësues/përfaqësuese të bashkësisë dhe përfaqësues/përfaqësuese nga organizatat partnere romë. Forumin e mbajti *Iniciativa e Grave nga Shuto Orizari*, me fokus në shpenzimet në të holla nga ndryshimet e reja të Ligjit për mbrojtje sociale.
- 1.113 qytetarë gjithsej u janë drejtuar pesë organizatave të regjistruara për sigurim të NJP-së, më shumë në fushën e mbrojtjes sociale; marrëdhënieve të punës; marrëdhënieve familjare; marrëdhënieve juridike-pronësore; mbrojtjes së viktimave të dhunës familjare; 34 qytetarë kanë dorëzuar kërkesa për NJP në MD, duke kërkuar avokat pa pagesë i cili do t'i përfaqësojë para gjykatës. Janë zbatuar dhjetë sesione për përforcim juridik dhe tri ditë informative ku qytetarët u njohën me të drejtat dhe obligimet e tyre në fushën e mbrojtjes sociale, marrëdhënieve të punës, dhunës së bazuar në bazë të gjinisë etj.

---

<sup>32</sup>OJSHSH – Opsione për Jetë të Shëndetshme Shkup; HERA – Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Huluntim; Shoqata për Emancipim, solidaritet dhe Barazi të Grave - ESE ; Iniciativa për Zhvillim dhe Inkluzion të Bashkësive; Shoqata për Zhvillim dhe Përparim të Bashkësisë Rome *Romano Çaçipe*; EHO – Organizata edukativo-humanitare – Shtip; Qendra Nacionale Rome – Kumanovë; Qendra Rinore Kulturore – Manastir; Asociacioni për Zhvillim Demokratik të Romëve – *Dielli* – Tetovë; *Burimi* – Strumicë; Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut; Shoqata për Edukim Juridik dhe Transparencës Stanica P.E.T. – Prilep; OJQ KHAM – Dellçevë; Klinika Juridike për Grupet e Lëndueshme; dhe Koalicioni *Margjinat*.

- Janë siguruar 664 shërbime juridike për 59 punëtorë seksualë, kurse tetë parajuristë në 555 takime siguruan ndihmë parajuridike për 141 punëtores seksuale. U janë siguruar 132 shërbime psikologjike gjithsej 26 punëtorëve seksualë. Është siguruar përfaqësim para gjykatave për 14 punëtorë seksualë dhe për një anëtarë të punëtore seksuale të vdekur. Prej tyre 12 janë përfshirë në procedurat e gjykatës për shkelje të një numri të madh të drejtash të njeriut në kontrollin policor të zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) "Suzbimi i prostitucionit në rrugë", në nëntor të vitit 2008, rast që përfundoi para gjykatave nacionale, por vazhdon para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).
- Tetë personave që përdorin drogë u është mundësuar përfaqësim para organeve kompetente vendase dhe të huaja, si vijon: në dy raste për posedim të substancave psikoaktive për përdorim personal; në një rast për mbrojtje nga dhuna ndaj fëmijës që përdor drogë; dhe dy aplikime në GJEDNJ për dy procedura për mbrojtjen e të drejtave të personave që përdorin drogë (nga dy aplikantë në secilën prej këtyre procedurave), dhe njëri për dhënie të paligjshme të të dhënave nga qendra e metadonit në Strumicë dhe tjetra për abuzim me ADN-në e një personi që përdor droga. Gjithashtu, është ngritur padi për diskriminim ndaj një personi i cili u pushua nga puna sepse mjekohet me terapi metadoni.
- Janë këshilluar 50 përfaqësues të bashkësive të ndryshme të marginalizuara, kurse 150 raste janë dokumentuar për shkelje të të drejtave të bashkësive të marginalizuara. Është siguruar përfaqësim i 20 klientëve në procedura penale, qytetare dhe administrative.
- Janë dhënë 1.497 informacione juridike për tekstilistët nga 60 fabrika tekstili dhe janë zbatuar katër takime informative me punëtorët. Është dorëzuar kërkesë në Inspektoratin Shtetëror të Punës për zbatimin e mbikëqyrjes së jashtëzakonshme inspektuese në shoqëri tregtare.
- Në Klinikën Juridike kanë punuar 36 studentë, prej të cilave katër janë nga gjeneratat e mëparshme të Klinikës Juridike për Grupet e Lëndueshme, të cilët vendosën të vazhdojnë me aktivitetet në klinikë. Studentët janë ndarë në katër njësi klinike. Janë mbajtur gjashtë trajnime për zhvillim të ndjeshmërisë së studentëve për punë me grupet e lëndueshme, në drejtim të ndërtimit të shkathtësive dhe njohurive për prezantim të informacioneve juridike gjatë punës me personat përfaqësues të grupeve të lëndueshme dhe të marginalizuara. Përveç kësaj, janë mbajtur edhe gjashtë trajnime për thellim të njohurive teorike, me qëllim që studentët në Klinikën Juridike fitojnë njohuri të specializuar teorike nga fusha e njësisë së tyre klinike.
- Janë mbajtur dy trajnime me parajuristët për fushat: e drejta e shëndetit, sistemi i mbrojtjes shëndetësore, sigurimi shëndetësor dhe mbrojtja e të drejtave të pacientëve. Në dy trajnime morën pjesë 46 pjesëmarrës gjithsej. Është siguruar

mbrojte parajuridike dhe mbështetje për realizimin e të drejtës nga fusha e mbrojtjes shëndetësore sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjes së të drejtave të pacientëve.

- Është realizuar punëtori me shoqatat e qytetarëve për risitë në sistemin për NJP, ku morën pjesë 18 pjesëmarrës nga dhjetë organizata qytetare gjithsej.
- Janë realizuar gjashtë sesione informuese për 135 qytetarë, familje sociale të rrezikuara, familje në rrezik ekonomik-social, prindër të fëmijëve dhe fëmijëve me shkathtësi të kufizuar, të bujqve dhe të tjera.
- Janë iniciuar tri kontekste administrative kundër vendime të MPPS-së. Në këto raste, edhe pse ka argumente dhe dëshmi mjaft të fuqishme prej të cilave mund të shihet nevoja për realizim të të drejtës për kompensim në para (pension apo ndihmë sociale), Qendrat e punës sociale kanë marrë vendime negative, të cilat mandej janë vërtetuar edhe nga MPPS-ja.
- Në pjesë të ndryshme të shtetit janë evidentuar rreth 15 raste të cilat lidhen me të njëjtën çështje juridike, përkatësisht borxhet e vjetërsuara dhe të papaditura ndaj ndërmarrjeve publike.
- Janë iniciuar tri procedura në Agjencinë për Komunikime Elektronike, dy prej të cilave kanë përfunduar me sukses.
- Është ngritur një procedurë para Komisionit Rregullator të Energjetikës për zgjidhje jashtëgjyqësore të një kontesti me EVN Maqedoninë.
- Forcimi juridik ishte mbështetur edhe me aktivitete në media, në formën e artikujve të rregullt qëllimorë në radiostacionet dhe televizionet lokale, si edhe nëpërmjet mediave sociale. Janë përgatitur tri video për promovim të ligjit të ri, Ligjit për ndihmë juridike pa pagesë.

Për arritjen e qëllimit të tretë specifik, me rëndësi të veçantë do të jetë realizimi i projektit **Qasje te drejtësia për më të marginalizuarit**, për të cilin FSHHM-ja fitoi grant nga Bashkimi Evropian nga fundi i vitit 2019. Qëllimi i këtij projekti është të mundësohet mbrojtja e të drejtave të njeriut nëpërmjet përforcimit juridik për përparimin e qasjes te drejtësia për grupet më të marginalizuara, me fokus te romët, njerëzit që përdorin drogë, punëtorët seksualë, fëmijët dhe familjet në rrezik social dhe bashkësitë e tjera të lëndueshme. FSHHM-ja do ta realizojë projektin në partneritet me OJSH – Opsione për jetë të shëndetshme Shkup dhe Shoqatën për edukim juridik dhe transparencë STANICA P.E.T. Prilep, në periudhën nga janari 2020 deri në korrik të vitit 2021.

**ARRITJET KRYESORE DHE/OSE AKTIVITETET QË E KANË  
SHËNUAR PUNËN E ORGANIZATAVE TË MBËSHTETURA  
NË SUAZAT E FUSHAVE STRATEGJIKE TË FSHHM  
NË VITIN 2019**

## FUSHA: MJEDIS MUNDËSUES PËR SHOQËRI QYTETARE

Në suazat e fushës *Mjedis mundësues për shoqëri qytetare*, në vitin 2019 FSHHM-ja vendosi bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm (SP) të Qeverisë së RMV-së, njësinë për Bashkëpunim me Organizatat Joqeveritare në SP dhe me Këshillin e Qeverisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Sektorit Qytetar, për mbështetje financiare dhe eksperte për përgatitje të "Analizës së mbështetjes financiare të shoqatave dhe fondacioneve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut (nga viti 2017 deri në gjysmën e parë të vitit 2019), me analizë krahasuese mbi modelet e financimit shtetëror nga vendet e tjera dhe propozim-modelit të Fondit për Mbështetje dhe Zhvillim të Shoqërisë Qytetare dhe kofinancim të projekteve të BE-së në RMV".

FSHHM-ja mori pjesë aktivisht në zbatimin e **Projektit të USAID-it për pjesëmarrje qytetare**, si organizatë partnere, nga janari i vitit 2017 deri në fund të prillit të vitit 2019, dhe administrativisht e përfundoi projektin në qershor të vitit 2019, me dorëzim të raportit narrativ final dhe financiar. Pas revizionit të kryer për vitin 2018, shtëpia ndërkombëtare e revizionit KPMG dha mendim pozitiv mbi punën financiare dhe procedurat e FSHHM-së në suazat e projektit.

Roli i FSHHM-së ishte të zbatojë aktivitetet për zhvillim të kapaciteteve të grantistëve të mbështetur nëpërmjet projektit. Në vitin 2019, aktivitetet e FSHHM-së kontribuuan në përforsimin e kapaciteteve të 14 organizatave qytetare dhe tri rjetave të organizatave qytetare, grantistë të projektit. FSHHM-ja siguroi mbështetje për zbatim të planeve individuale për ndërtim të kapaciteteve të çdo grantisti, të përpunuara në bashkëpunim me organizatat. Mbështetje përfshinte trajnime, evenimente për të mësuar njëri nga tjetri (mësim bashkëmoshatar) dhe rjetëzimi, mentorimi individual dhe/ose ndihma eksperte, në përputhje me nevojat dhe prioritetet për përmirësim organizativ të çdo organizate.

## FUSHA: TË DREJTAT STUDENTORE DHE ANGAZHIMI

Nëpërmjet mbështetjes së disa organizatave qytetare në fushën *Të drejtat studentore dhe angazhimi*, FSHHM-ja ka për qëllim t'i përparojë të drejtat studentore dhe angazhimin e të rinjve për politika më të mira rinore dhe studentore dhe për transparencë dhe llogaridhënie më të madhe në arsimin e lartë. Një përfaqësues nga FSHHM-ja mori pjesë, gjithashtu, në debatet publike të organizuara në Kuvendin e RMV-së, ku fjalime të tyre kishin organizatat rinore dhe faktorët relevantë në sferën e mbështetjes së Ligjit për pjesëmarrje rinore, si dhe në panel-diskutimet e organizuara nga Agjencia për të Rinjtë dhe Sportin, në drejtim të mbështetjes së iniciativave për Ligj për të rinj, por edhe për rishqyrtim të Strategjisë ekzistuese për të rinjtë në RMV dhe krijim të planeve aksionare për periudhën në vijim.



*Shoqata e qytetarëve Forumi Arsimor Rinor (FAR)* me ndihmë të mbështetjes financiare të dhënë mori pjesë aktivisht në mbikëqyrjen e politikave dhe praktikave ekzistuese studentore dhe rinore dhe në krijimin e politikave dhe praktikave të reja studentore dhe rinore dhe në monitorimin e zbatimit të tyre nga institucionet dhe organet kompetente. *FAR* me përfaqësuesit e vet mori pjesë në grupin e punës për krijim të Ligjit për pjesëmarrje rinore, i cili u miratua në vitin 2020 dhe për herë të parë kontribuoi për rregullativë përkatëse në drejtim të mbështetjes së të rinjve dhe aktivizmit dhe pjesëmarrjes rinore. Me anëtarët e vet *FAR*, dha kontribut në grupin e punës për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për arsimin e mesëm, në pjesën e organizimit të nxënësve dhe pjesëmarrje, grupin e punës për standardin studentor dhe grupin e punës për standardin e nxënësve, standardin rinor, grupi ku ka iniciativë për rregullim të "punëtorit rinor" si dhe Strategjisë nacionale për zhvillim të konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në klasterin të rinjtë dhe klasterin arsimit. *FAR-i* është në komunikim, koordinim dhe bashkëpunim të përhershëm me Agjencinë për të Rinj dhe Sport për rishqyrtim të Strategjisë nacionale për të rinjtë dhe krijimin e planeve të reja aksionare.

*FAR-i* e vazhdoi edhe punën e vet në suazat e programeve *Debati*, *Mësojmë drejtësi dhe Aktivizëm*, ku në vitin shkollor 2019/2020 funksionuan klubet rinore në Shkup, Veles, Tetovë, Kumanovë, Manastir, Strugë dhe Prilep. Ligjërimet u realizuan një herë në javë, sipas një kurrikule të përcaktuar paraprakisht. Mandej, programi debutues në vitin shkollor 2019/2020 realizoi bashkëpunim me tri shkolla të mesme nga Shkupi, si vijon: SHMQSH "Josip Broz Tito", SHMQSH "Nikolla Karev" dhe SHMQSH "Orce Nikollov", në hapësirat e të cilave mbahen takime dhe ligjërime në klubet e atjeshme. Programi debutues përgatiti edhe dy kurrikula të reja për nivelin fillestar dhe të përparuar të debatit dhe filloi me zbatimin e "sistemit mentor" ku një ligjërues më me përvojë nga Shkupi është mentor i një ligjëruesi të ri nga klubi apo nga ndonjë qytet tjetër në shtet, me qëllim që t'u sigurohet mbështetje shtesë ligjëruesve të rinj.

*FAR* ka reaguar publikisht edhe e shprehu mospajtimin e vet me rebalancin e Buxhetit, ku për arsimin janë paraparë 14 milionë euro më pak. Për këtë shpallje kishte reagime pozitive në opinion ishte shpërndarë nga një numër i madh mediash dhe gjeti mbështetje nga organizatat qytetare të cilat iu bashkëngjitën reagimit të shkurtimit të mjeteve financiare për arsimin. Së bashku me 15 organizata qytetare, *FAR* reagoi për zvogëlimin e theksuar të Buxhetit në fushën e arsimit të lartë, ku futet dhe strehimi studentor.

Gjatë vitit 2019, ekipi i *Radio MOF* u rrit me dy studentë të cilëve u është mundësuar ta realizojnë praktikën e vet dhe të mësojnë në këtë medium rinor. Në fillim të tetorit është instaluar butoni "Paraqit problem", nëpërmjet të cilit paraqiten probleme lidhur me arsimin, për të cilat mandej punoheshin tekste hulumtuese. *Radio MOF* vazhdoi me produksionin e emisionit "Në orë", i cili në vitin 2019 pati 8.379 shikime.

Në nëntor dhe dhjetor 2019, për herë të parë, u mbajtën zgjedhjet për përfaqësuesit e studentëve në organet e universitetit dhe fakulteteve, sipas Ligjit të ri për Arsimin e Lartë të miratuar në vitin 2018. FAR e informonte rregullisht të gjithë publikun, veçanërisht studentët, për mundësinë e kandidaturës dhe për zgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve, kurse në të njëjtën kohë trajnoi 30 të rinj të cilët i vëzhguan zgjedhjet në Universitetin "Shën. Kirili dhe Metodij" në Shkup. Sipas mbikëqyrësve të FAR-it, zgjedhjet studentore kaluan pa incidente të mëdha dhe ndërprerje në procesin zgjedhor. Në listat e zgjedhësve ishin regjistruar 25 444 studentë. Fatkeqësisht, jo të gjitha fakultetet kanë shpallur numrin e studentëve që e ushtruan të drejtën e tyre të votës. Nga informacioni në disponim, në 11 nga 23 fakultetet, ku studiojnë 55.9% e studentëve me të drejtë vote ka pasur pjesëmarrje prej 14.09%.

Kishte rivotim në dy fakultete për shkak të parregullsive (më shumë fletëvotime në kutitë e votimit sesa kishte studentë të nënshkruar në listën e zgjedhësve, studentë që votuan dhe nuk ishin në listat e votuesve, d.m.th. u lejuan të votojnë pa u identifikuar). Është e rëndësishme që të gjitha këto mangësi janë vërejtur nga komisionet zgjedhore të fakulteteve, dhe gjatë rivotimit në këto fakultete nuk janë vërejtur parregullsi. Nga pikëpamja tekniko-logjistike, përfundimet janë që shumica e fakulteteve nuk ishin të pajisura me materialet e duhura zgjedhore, siç janë kutitë e votimit dhe kutitë transparente. Për ilustrim, vetëm në Fakultetin e Filologjisë "Bllaze Koneski" u vendos paravan që të votojnë njerëzit me aftësi të kufizuara fizike. Në suazat e të gjitha fakultetet, në këto zgjedhje u zgjodhën gjithsej 390 anëtarë të kuvendeve të fakultetit.

Në vitin 2019, FAR shënoi 20-vjetorin e ekzistencës së vet si një organizatë rinore me disa aktivitete dhe ngjarje, më e rëndësishmja prej të cilave ishte "Konferenca për rininë dhe arsimin", ku në tre panel diskutime u diskutua mbi temat: "Arsimi joformal: korrigjues apo pjesë integrale e procesit arsimor?", "E ardhmja e arsimit - çfarë (duhet) të pasojë?" dhe "Çështjet rinore që (së shpejti) do të bëhen përparësi". Në këtë eveniment ishin të ftuar anëtarët e FAR-it, organizatat partnere afatgjata, si dhe institucionet dhe bashkëpunëtorët në fushën e arsimit joformal dhe politikave rinore. Midis të tjerëve, në këtë konferencë ishin të ftuar Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Z. Arbër Ademi, Ivana Tufekxhiq, deputete në Parlamentin e RMV-së, përfaqësuesja e UNICEF-it në RMV, disa ish-drejtorë ekzekutivë dhe presidentë të FAR-it, si dhe përfaqësues të organizatave rinore partnere, donatorë, profesorë universitarë dhe drejtorë të shkollave të mesme.

FSHHM-ja e mbështeti projektin "Transparenca financiare dhe llogaridhënia në arsimin e lartë dhe shkencë në RMV" të *Sindikates së Pavarur Akademike Shkup (SPASH)*. Qëllimi i projektit është që nëpërmjet analizave, hulumtimeve dhe rekomandimeve të pushteteve arsimore dhe institucioneve të larta arsimore të theksohet rëndësia transparencës dhe të ndikohet për transparencë më të madhe në financimin e arsimit të lartë, si edhe për llogaridhënie dhe inkluzivitet më të madh në procese. Gjatë vitit 2019 SPASH bëri analiza dhe hulumtime lidhur me qasjen në buxhetin e MASH-it, analizë të buxhetit për arsimin e lartë, për detektimin e procedurës dhe kriterëve për dhënie e

mjeteve në universitetet publike dhe institucionet shkencore, të bazave ligjore për rregullimin e rrogës të të punësuarve në universitetet publike dhe institucionet shkencore në RMV, si dhe hulumtime mbi perceptimin e publikut për vlerësimin e punës akademike në institucionet e larta publike. Gjetjet dëshmuar një sërë paqartësish dhe mospërputhjes në krijimin, prezantimin, miratimin dhe kontrollin e shpenzimeve të buxhetit për arsimin e lartë dhe shkencën, mungesë të kuadrit më të ri universitar, dallime të mëdha në madhësinë dhe mënyrën e formimit të rrogave të kuadrit akademik midis universiteteve publike dhe institucionet e larta arsimore në të njëjtat universitete, etj. SPASH-i i shpërndau këto gjetje me MASH-in dhe me publikun, kurse për to u diskutua edhe në tribunat e mbajtura në muajt shkurt dhe mars 2020.

Në suazat e thirrjes për grante për aksione të përbashkëta për analiza, monitorim dhe përfaqësim lidhur me krijimin dhe/ose realizimin e politikave studentore dhe rinore, FSHHM-ja dha dy grante, si vijon:

(1) **Rrjeta për Parandalim të Ikjes së Trurit**, e udhëhequr nga Shoqata e Liderëve për Edukim, Aktivizëm dhe Zhvillim nga Shkupi, ku marrin pjesë: 1) Qendra për Aktivizëm Rinor QAK KRIK, Shkup; 2) Shoqata për Disleksion Ajnshtajn, Shkup; 3) Qendra për Zhvillim Multidisiplinor QZHM Proces, Shkup; 4) Shoqata Aleanca Rinore, Krushevë; 5) Asociacioni për Edukim Mlladiinfo Internacional, Shkup; dhe 6) Shoqata e Qytetarëve Të Rinjtë mund, Shkup mori mbështetje të zbatojë analizë dhe monitorim të zbatimit të "Strategjisë nacionale për rretëzim, bashkëpunim dhe zvogëlim të ikjes së kuadrove profesionale dhe me arsim të lartë 2013 – 2020" dhe të zbatojë proces konsultativ me të gjitha palët e prekura për gjenerim të rekomandimeve, politikave dhe masave për zvogëlim të ikjes së të rinjve dhe kuadrove me cilësi të lartë nga vendi. Projekti filloi me konferencë për shtyp dhe tribunë ku morën pjesë udhëheqës të institucioneve relevante, siç janë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Agjencia për të Rinj dhe Sport dhe Agjencia e Emigracionit, ku u diskutua për masat nacionale për parandalim të ikjes së trurit. Nga diskutimi me të rinjtë e pranishëm u konkludua se ato masa nuk kanë ndihmuar në drejtim të ndryshimit të trendit të emigrimit të të rinjve nga shteti, që e dëshmuar edhe një sërë hulumtimesh të botuara në vitin 2019. Organizatat partnere në rretë, nëpërmjet mediave dhe intervistave e njohën publikun me aktivitetet e planifikuara, kurse u krijua edhe metodologjia për mbledhje e të dhënave mbi të cilat do të bazohet analiza e strategjisë, pas së cilës u analizuan edhe të dhënat e mbledhura nëpërmjet gjashtë intervistave të detajuara. Në vitin 2019 u zbatua anketë për publikun prej së cilës u mor një numër i rëndësishëm (1.190) përgjigjesh të cilat do të shërbejnë për analizën përkatëse për të cilën është planifikuar të publikohet për publikun në tremujorin e parë të vitit 2020 dhe të japë propozime për masat e mëtejshme për parandalim të ikjes së trurit.

(2) **Rrjeta për (Ri)formim Studentor** e Këshillit Nacional Rinor të Maqedonisë me këto organizata partnere: *Fondacionin për Zhvillim të Bashkësisë Lokale, Shtip*; 2) *Shoqatës për Aktivizëm Qytetar FORUM 16, Manastir*; 3) *Qendra Rinore Kulturore, Manastir*; 4) *Shoqata për Zhvillim të Qëndrueshëm SFERA INTERNASHNAL, Manastir*; dhe 5) *Qendra për Edukim dhe Zhvillim QEZH, Tearcë*, mori mbështetje që të adresojë çështjen e organizimit studentor dhe ta ndjekë procesin e vendosjes së modelit të ri të organizimit studentor në tri universitetet shtetërore, përkatësisht Universitetin "Goce Dellçev" në Shtip; Universitetin "Klimenti i Ohrit" në Manastir dhe Universitetin në Tetovë. Sipas planifikimit, projekti duhet të nxisë pjesëmarrjen aktive të studentëve në këto procese, nëpërmjet informimit dhe motivimit të tyre më të madh për përfshirje në proceset e marrjes së vendimeve dhe përfaqësimit të studentëve para organeve universitare. Nëpërmjet zhvillimit të një plani të detajuar për përfaqësim dhe koordinim, partnerët e projektit filluan një fushatë për organizimin studentor, e cila i informoi studentët për të drejtat dhe mundësitë e tyre që të marrin pjesë në punën e universitetit, por edhe për modelin e ri të organizimit studentor. Mandej, përfaqësimi ishte drejtuar edhe kah menaxhimin, dekanatit dhe rektoratit të tri universiteteve, me qëllim të zbatimit të përpiktë të dispozitave ligjore dhe krijimin e një sistemi efektiv të organizimit studentor. Gjithashtu, organizatat partnere lokale, nëpërmjet punonjësve të tyre në terren, i monitoruan vazhdimisht proceset në secilin prej tri universiteteve shtetërore dhe përgatitën raporte monitorimi dhe rekomandime për procesin. Në përgjithësi, sipas të dhënave të marra fillimisht nga zgjedhjet e zhvilluara në universitetet në Shtip dhe Manastir, pjesëmarrja e studentëve është relativisht e vogël (më pak se 15%), por pa gjetje të dukshme të parregullsive. Fatkeqësisht, organizata partnere nga Tetova pati probleme në mbledhjen e të dhënave për zgjedhjet studentore në Universitetin Shtetëror të Tetovës, duke pasur parasysh mostransparencën e përfaqësuesve të studentëve dhe pamundësinë për qasje në dokumentet dhe informacionet e kërkuara. Raporti për analizën e zgjedhjeve studentore në këto tri universitete shtetërore do të përgatitet në tremujorin e parë të vitit 2020 dhe do të ndahet me dekanatet dhe administratën e universitetit dhe publikun e gjerë.

FSHHM-ja, me mbështetjen e *Programit të arsimit të lartë të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur*, mundësoi realizimin e projektit "Konvikte studentësh pa korrupsion" të FAR-it. Qëllimi ishte të mbështetet aktivizmi i studentëve për zmadhim të transparencës dhe llogaridhënies së konvikteve studentore dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve që i marrin studentët në konviktet në Shkup.

FAR zbatoi hulumtim në ekzemplar prej 300 të anketuarish (studentë-banues) të cilët jetojnë në konviktet shtetërore studentore (KSHS) "Kuzman Josifovski-Pitu", "Goce Dellçev" dhe "Stiv Naumov" në Shkup. Hulumtimi u fokusua në standardin jetësor të studentëve, pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje, si dhe perceptimin e tyre për format e ndryshme të korrupsionit që janë të pranishme në konviktet studentore. Raporti hulumtues "Jetë studentore e arnuar" dëshmoi se studentët e vlerësojnë gjendjen në

konviktin ku banojnë me notë mesatare 2,93 nga 5, duke i veçuar kushtet e këqija për jetën, mungesën e mjeteve dhe hapësirave për të mësuar dhe mungesën e aktiviteteve kulturore dhe sportive si pikat kryesore për përmirësim. Sipas hulumtimit, edhe pse kërkesat themelore për pjesëmarrje janë përmbushur ligjërisht, 92% e të anketuarve deklaruan se kurrë nuk kanë marrë pjesë në vendimmarrje në konvikte, kurse 70% kanë njohuri të vogla për organet drejtuese që funksionojnë në suazat KSHS-ve. Si arsye për mospjesëmarrjen e tyre janë: mungesa e kohës, mungesa e informacionit për mekanizmat për pjesëmarrje dhe mungesa e besimit se ata mund të ndryshojnë ndonjë gjë. 40% e të anketuarve raportuan korrupsion në konviktet studentore, më shumë se 33% kanë pasur përvojë personale me ndonjë prej rasteve të hetuara të korrupsionit dhe/ose njohin dikë të cilit i kishte ndodhur. Mbi 70% e të anketuarve nuk do të merrnin pjesë në veprimet korruptuese të hulumtuara, 89% e të anketuarve nuk e dinë se ku mund të raportojnë korrupsion, kurse madje 53% e të anketuarve nuk do të raportonin korrupsionin tek organet kompetente. FAR, gjithashtu bëri një analizë të prokurimeve publike në konviktet studentore në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2018, se sa dhe si KSHS-ja e alokon dhe e shpenzon buxhetin për nevojat e studentëve. Analiza tregoi ndarje të ulëta vetëm 61 denarë në ditë për produktet për përgatitjen e mëngjesit, drekës dhe darkës për studentët. Shpenzimet për ushqimin për studentët përbëjnë vetëm 15% të shpenzimeve totale të KSHS-së. Gjetjet e dy hulumtimeve u ndanë me institucionet përkatëse dhe pushtetet arsimore dhe u përdorën për të përfaqësuar ndryshimet në ligjin e ri, Ligjin për standardet e studentëve, i cili është në përgatitje. Në suazat e projektit, u mbështetën tri nisma studentore për të përmirësuar kushtet e jetesës në konvikt, të cilat rezultuan me një leximore të rinovuar dhe bibliotekë të pajisur në "Stiv Naumov", një disko dhe oborr i rinovuar në "Kuzman Josifovski-Pitu" dhe një kënd lojërash i rinovuar për t'u marrë me sport banorët në "Goce Delçev".

Në nëntor të vitit 2019, FAR-i mori një mbështetje shtesë nga Programi për arsimin e lartë i Fondacioneve të Shoqërive të Hapura për projektin "Studentë të angazhuar për konvikte studentore pa korrupsion" dhe e vazhdoi punën e vet me konviktet studentore, duke e zgjeruar hulumtimin edhe në dy konviktet më të mëdha studentore jashtë kryeqytetit (në Manastir dhe në Shtip), si edhe në një nga konviktet më të mëdha shtetërore studentore në Shkup (Konviktin studentor shtetëror "Pellagonija"). Me qëllim që të përmirësohet standardi studentor dhe të krijohen studentë aktivë që i njohin të drejtat dhe obligimet e tyre, në 12 muajt e ardhshëm FAR, me ndihmë të tri organizatave rinore lokale, do të punojë në zbatimin e aksioneve lokale për përmirësim të kushteve në konvikte, në organizim të trajnimit dhe të krijimit të udhëzuesit për të drejtat studentore.

## FUSHA: POLITIKAT SHËNDETËSORE TË BAZUARA NË TË DREJTAT

Në suazat e fushës *Politikat shëndetësore të bazuara në të drejtat*, FSHHM-ja mbështet organizata qytetare të cilat punojnë në përparimin e politikave shëndetësore që mundësojnë realizim të shërbimeve shëndetësore dhe të drejtave të bashkësive të marginalizuara (LGBTI, romët, personat që përdorin drogë, punëtorët/punëtoret seksuale dhe njerëzit që jetojnë me HIV).

Në vitin 2019 u janë dhënë grante institucionale: *Shoqatës për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE; HOPS – Opsione për Jetë të shëndetshme Shkup; Koalicioni Margjinat; dhe Shoqata për Mbështetje të Punëtorëve të Margjinalizuar STAR-STAR*; grantet e projekteve për monitorim të buxheteve në programet për zvogëlim të dëmeve, si dhe grantet e shoqatave që punojnë në ndryshimin e narracioneve negative për romët, për mbështetje të aktiviteteve të tyre në drejtim të realizimit të qëllimeve specifike: (1) ndjekja dhe analiza e buxhetit shëndetësor dhe kërkesa për llogaridhënie nga pushtetet për shpërndarjen maksimale të mjeteve në dispozicion të cilat do të mundësojnë realizim progresiv dhe jodiskriminues të të drejtave shëndetësore; (2) përfaqësim për reforma në politikat shëndetësore, në përputhje me nevojat e bashkësive; dhe (3) mundësimi i përfshirjes dhe pjesëmarrjes së bashkësive të prekura në planifikimin, ndjekjen dhe evaluimin e zbatimit të politikave shëndetësore.

**Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave - ESE (ESE)** gjatë vitit 2019 mori pjesë aktivisht në ndjekjen e realizimit të politikave ekzistuese dhe krijimin e politikave të reja në fushën e shëndetësisë. Me ftesë të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), përfaqësues të ESE-s morën pjesë në shumë grupe pune për përgatitjen e Ligjit për mbrojtje shëndetësore, ku u dorëzuan 55 propozime gjithsej<sup>33</sup> nga shoqata dhe nga 20 organizatat e tjera qytetare me të cilat bashkëpunon. Për shkak të pakënaqësisë nga mënyra e udhëheqjes së procesit nga MSH-ja dhe transparencës së pamjaftueshme, kurse me qëllim që të zbatohet përfaqësim shtesë për tejkalimin e problemeve të përcaktuara në përgatitjen e Ligjit, problemet me të cilat u ballafaquan organizatat qytetare janë argumentuar në seancën e 13 të Këshillit për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Sektorit Qytetar. ESE mori pjesë në përgatitjen e planit aksionar për pako minimale të shërbimeve për shëndetin seksual dhe riprodhues në kushte të gjendjeve të jashtëzakonshme dhe të krizave, në pjesën e planit i cili përmban aktivitetet për mbrojtjen shëndetësore të nënave dhe të fëmijëve në gjendjet e krizës; në përgatitjen e programit për mbrojtje aktive të shëndetit të nënave dhe fëmijëve, kur janë dorëzuar dhe pranuar kërkesat për miratim të aktiviteteve kushtuar mjediseve rreth; dhe në procesin e planifikimit të reformave në mbrojtjen primare shëndetësore, i organizuar nga MSH-ja dhe OSHB-ja, ku janë prezantuar gjetjet dhe rekomandimet që lidhen me

---

<sup>33</sup> Propozimet bazohen në të dhënat dhe argumentet e elaboruara që dalin nga përvojat e punës të këtyre organizatave, si dhe nga nevojat reale të qytetarëve, dhe janë në drejtim të përparimit të shkallës së mbrojtjes shëndetësore të popullatës, me fokus të veçantë në grupet e lëndueshme të popullatës (duke përfshirë romët, personat me sëmundje të rralla, personat LGBTI, të rinjtë, njerëzit që jetojnë me HIV, personat që përdorin droga dhe grupe të tjera).

shërbimet e patronazhit, gjinekologët amë dhe ekipet parandaluese për shëndetin e fëmijëve në shtëpitë shëndetësore, si edhe kërkesat për përfshirje të bashkësisë në procesin e planifikimit, zbatimit dhe evaluimit të shërbimeve shëndetësore në nivel primar, me theks të veçantë mbi grupet e lëndueshme të popullatës. ESE mori pjesë në përgatitjen e Strategjisë për mëmësi të sigurt, Strategjisë për shëndetin riprodhues, Planit për reforma në mbrojtjen shëndetësore primare, Protokollin për mbrojtjen shëndetësore gjatë shtatzënisë dhe pas lindjes dhe në përgatitjen e akteve të tjera nënligjore.

Përveç kësaj, ESE dorëzoi kërkesa në Qeveri dhe MSH të cilat lidhen me masat e nevojshme që duhet të ndërmerren nga shteti që t'i plotësojë obligimet e parapara në Deklaratën politike të Kombeve të Bashkuara për mbrojtje shëndetësore universale deri në vitin 2030. Kërkesat i janë dhënë dhe publikut dhe janë transmetuar nga mediat. Me rekomandimet e veta, ESE mori pjesë në revizionin e Planit nacional aksionar për përparimin e shëndetit të romëve, si dhe në grupet e punës për planifikim dhe zbatim të Planit nacional aksionar për Partneritet të hapur qeveritar për vitin 2018-2020.

Meqenëse është konstatuar se në shëndetësinë maqedonase vite me radhë nuk janë ndarë mjete të mjaftueshme për aktivitete parandaluese, gjatë vitit 2019, vazhdoi përfaqësimi për zmadhimin e buxhetit për mbrojtje shëndetësore parandaluese. Ministrit të shëndetësisë dhe Ministrit të financave u janë dërguar kërkesa për zmadhim të buxhetit për mbrojtje shëndetësore parandaluese. Ndjekja dhe analiza e buxheteve<sup>34</sup> të programeve të miratuara në vitin 2019 dëshmoi një përmirësim të caktuar në drejtim të zmadhimit të buxhetit të tërësishëm, kështu buxheti për Programin për mbrojtje aktive shëndetësore të nënave dhe fëmijëve është zmadhuar me 2.000.000 denarë, buxheti për Programin për kontrole sistematike të studentëve dhe nxënësve me 5.270.000 denarë, buxheti për Programin për mjekim të sëmundjeve të rralla është zmadhuar me 29.907.000 denarë, kurse buxheti për Programin skringing të tumorit në gji është zmadhuar me 170.000 denarë. Në periudhën e raportit prapësim shihet vetëm te Programi për skringing të tumorit në qafën e mitrës, ku mjetet janë zvogëluar me 2.800.000 denarë dhe janë ndërprerë aktivitetet kushtuar romëve, masa e vetme e cila për herë të parë është miratuar në vitin 2018.

Si pjesë e aktiviteteve të përfaqësimit në nivel nacional, kurse me qëllim që të përparohet shëndeti i romëve, shëndeti riprodhues i grave dhe shëndeti i nënave dhe fëmijëve, u mbajt debati publik me konferencë për shtyp<sup>35</sup>, ku përveç përfaqësuesve të organizatave qytetare u drejtuan edhe përfaqësuesit e bashkësisë romë nga Shuto Orizari dhe nga Dellçeva. Në këtë debat publik janë treguar gjetjet nga puna e ESE-s dhe organizatat partnere romë në zbatimin e qasjes së integruar, si dhe kërkesat për përmirësim të gjendjeve në lidhje me përparimin e shëndetit të romëve, me theks të veçantë mbi gratë, nënat dhe fëmijët. Në këtë debat morën pjesë përfaqësues të

---

<sup>34</sup>Gjendet në : <http://www.esem.org.mk/index.php/biblioteka/najnovi-publikacii-izdaniija.html>

<sup>35</sup>Gjendet në: <https://www.youtube.com/watch?v=u4AFKmmPMr8>

mediave, organizatave qytetare, institucioneve shëndetësore publike dhe të organizatave ndërkombëtare.

Në suazat e punës së saj për përfshirjen e qytetarëve në proceset e planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të normativës ligjore, buxheteve dhe shërbimeve në fushën e të drejtave sociale dhe ekonomike, ESE vazhdoi të sigurojë mbështetje teknike të vazhdueshme, mentorim dhe supervizion të punës së tri organizatave romë të cilat zbatojnë qasje të integruar në shfrytëzimin e llogaridhënies sociale dhe fuqizimit ligjor në bashkësitë romë në lidhje me aktivitetet e mëposhtme: Puna në bashkësi (kryerja e hartës së bashkësisë dhe mobilizimi); mbledhja dhe analizimi i të dhënave nga bashkësia romë; përpunimi dhe analiza e procesit të monitorimit dhe analizës së buxheteve në nivelin lokal; sigurimi i ndihmës parajuridike; dhe përgatitja dhe zbatimi i strategjive lokale të përfaqësimit.

Përveç se për organizatat qytetare vendase, ESE zbatoi trajnime dhe mentorim për përforsim të kapaciteteve të organizatave qytetare nga Evropa Juglindore (Bullgaria dhe Rumania) të cilat punojnë mbi përparimin e shëndetit të romëve, në raport të zbatimit të metodologjive të llogaridhënies sociale dhe përforsimit juridik. Është mbajtur një punëtori dyditore për 15 organizata qytetare nga Bullgaria, kurse për një organizatë nga Rumania sigurohet ndihmë e vazhdueshme teknike. Në panairin ndërkombëtar në Salzburg, para pjesëmarrësve të organizatave qytetare, universiteteve dhe institucioneve të tjera nga Evropa Qendrore dhe Juglindore një përfaqësuesi i ESE-s i prezantoi përvojat mbi zbatimin e llogaridhënies sociale dhe përforsimit juridik në përparimin e shëndetit të romëve në Maqedoninë e Veriut.

Për dy organizata qytetare nga Mali i Zi dhe nga Serbia, që punojnë mbi programe për zvogëlim të dëmeve, është siguruar ndërtim i kapaciteteve dhe qëndrimit për zbatimin e metodologjive të monitorimit dhe analizës së buxheteve. Si pjesë e angazhimit në këtë fushë, për nevojat e procesit të përfaqësimit që e zbaton *HOPS-i – Opsione për Jetë të Shëndetshme Shkup*, ESE përgatiti analizën “Mundësi për financim të programeve për zvogëlim të dëmeve nga përdorimi i drogave në RMV, nëpërmjet përdorimit të akcizës së cigareve, alkoolit dhe të birrës”. Në punëtorinë ndërkombëtare në Zagreb “Përfaqësim dhe kujdes i fokusuar te njerëzit” në organizim të ERS/TBES, një përfaqësues i ESE-s lehtësoi sesionin për zhvillim të planeve për përfaqësim për financim të programeve për suzbim të tuberkulozës nëpërmjet buxheteve nacionale.

Në suazat e bashkëpunimit me institucionet, ESE do të punojë në përforsimin e kapaciteteve të MSH-së dhe institucioneve shëndetësore publike duke zbatuar trajnime dhe duke siguruar mbështetje mentoruese në procesin e futjes dhe zbatimit të qasjeve inovative për përfshirjen e qytetarëve në ndjekjen, krijimin dhe zbatimin e programeve shëndetësore parandaluese. Në vitin 2019, si një pilot projekt, MSH-ja zgjodhi Programin e mbrojtjes së popullsisë nga HIV/SIDA.

Përveç analizave të ndjekjes së buxheteve të programeve parandaluese, gjatë vitit 2019, ESE punoi edhe analizë të shkaqeve për trendet e zmadhimit të vdekshmërisë së



foshnjave të porsalindura dhe vdekshmërinë perinatale në Maqedoni, si edhe analizë të mangësive të sistemit për mbledhjen e të dhënave për këta indikatorë, që doli nga bashkëpunimi me grupin e ekspertëve relevantë, me Drejtorinë për Shëndetësi Elektronike dhe nga analiza e të dhënave në dispozicion. Finalizimi dhe promovimi i analizës janë paraparë në vitin 2020. Në gjysmën e dytë të vitit 2019, janë mbledhur të dhëna për përgatitjen e analizës makroekonomike për buxhetin e tërësishëm për mbrojtjen shëndetësore të grave, nënave dhe fëmijëve, nëpërmjet tri aspekteve: shpenzime të MSH-së, shpenzime të Fondit të Sigurimit Shëndetësor dhe pagesat private nga pacientët. Analiza do të finalizohet gjatë vitit 2020.

Është përgatitur analiza "Sa kushton puna pa pagesë për kujdes në kushte shtëpiake?"<sup>36</sup>, e cila bazohet në të dhënat e hulumtimit të mëparshëm për amvisëritë ku sigurohet kujdes për personat e sëmurë dhe të pamundshëm. Analiza i tregon: kohën e nevojshme për sigurim të kujdesit, si edhe shpenzimet që lidhen me sigurimin e kujdesit. Gjithashtu, analiza mundëson mbikëqyrje në ndikimin e sigurimit të kujdesit të tillë mbi dhënësit primarë të kujdesit, duke përfshirë edhe ndikimin mbi aftësinë për punë, mundësitë për përfitim personal, shëndetin etj., si dhe ndikimin mbi të gjithë amvisërinë duke përfshirë edhe rritje e shpenzimeve të amvisërive, zvogëlimin e të hyrave etj.

Në planin e transparencës fiskale, ESE zbaton rregullisht vlerësim të jashtëm të shkallës së transparencës dhe llogaridhënies fiskale të institucioneve në fushën e të drejtave sociale dhe ekonomike. Janë përgatitur raporte <sup>37</sup> me vlerësime të nivelit të transparencës proaktive në 26 institucione dhe nivelit të transparencës reaktive në 85 institucione publike në vitin 2018, si dhe analizë e procesit të vlerësimit.

Është zbatuar edhe vlerësim i nivelit të transparencës së prokurimeve publike që i kanë zbatuar 62 institucione shëndetësore publike në vitin 2018. Në bazë të analizës së të dhënave nga gjithsej 9.696 procedura për prokurime publike që janë kryer në suazat e 3.136 projekteve të 62 institucioneve shëndetësore publike<sup>38</sup> (32 shtëpi të shëndetit kanë zbatuar 3 631 procedura për furnizime publike; 11 Qendra për shëndetin publik dhe Institucioni për Shëndetin Publik ka zbatuar 1532 procedura për prokurime publike; 16 spitale të përgjithshme dhe klinike kanë zbatuar 4082 procedura për prokurime publike; Klinika Universitare për Gjinekologji dhe Akusherëri ka zbatuar 312 procedura për prokurime publike, kurse MSH-ja ka zbatuar 139 procedura për prokurime publike) është përpiluar raport<sup>39</sup> i cili siguron informacione mbi mënyrën dhe dedikimin e mjeteve publike të shpenzuara në shëndetësinë publike nëpërmjet procedurave për prokurime

---

<sup>36</sup> Gjendet në: <https://www.esem.org.mk/pdf/Publikacii/2019/Neplatena%20rabota%20za%20nega.pdf>

<sup>37</sup> Gjendet në: <https://www.esem.org.mk/index.php/biblioteka/najnovi-publikacii-i-izdaniya.html>

<sup>38</sup> Institucionet e përfshira me këtë analizë janë institucione shëndetësore publike, që japin shërbime shëndetësore për gra, fëmijë dhe romë, dhe të cilat përputhen me programet shëndetësore parandaluese që fokusohen në monitorimin që e zbaton ESE.

<sup>39</sup> Gjendet në: [https://www.esem.org.mk/pdf/Publikacii/2019/Analiza%20Javni%20nabavki\\_MK.pdf](https://www.esem.org.mk/pdf/Publikacii/2019/Analiza%20Javni%20nabavki_MK.pdf)

publike; nivelin e transparencës gjatë zbatimit të prokurimeve publike; si shpenzohen mjetet e buxhetit dhe cila është dobia më e madhe nga procedurat e prokurimeve publike në shëndetin publik, dhe për cilat qëllime institucionet shëndetësore shpenzojnë pjesën më të madhe të mjeteve dhe sa prej këtyre mjeteve janë të argumentuara. Mandej, në këtë periudhë ESE vazhdoi me mbledhjen e të dhënave për procedurat e bëra nga të njëjtat institucione në vitin 2019, të cilat do të jenë këndë analize për periudhën e ardhshme.

Për nevojat e përgatitjes së raporteve, janë dorëzuar 2163 kërkesa për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik në 88 institucione publike. Për shkak të shkeljes së të drejtës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik janë dorëzuar 396 ankesa kundër 21 institucioneve publike.

Në drejtim të përmirësimit të nivelit të transparencës fiskale, po kryhet ndjekja e zbatimit të Planit nacional aksionar për Partneritet të hapur qeveritar 2018 - 2020 në fushën e transparencës fiskale dhe qasjes në informacionet me karakter publik. U mbajtën gjashtë takime koordinuese me institucionet publike të përfshira në zbatimin e PNA-së, si më vijon: me MSH-në, për të harmonizuar raportin për Programin për zbulim të hershëm të sëmundjeve malinje; me Agjencinë e Punësimit, për harmonizimin e përmbajtjes së raportit vjetor mbi punën e institucionit dhe për propozimin e një forme për raportim të rregullt në format të hapur; me Ministrinë e Financave, për koordinimin e aktiviteteve në suazat e prioriteteve për promovimin e transparencës fiskale dhe takimit konsultativ për zhvillimin e softuerit për shpallje publike të të dhënave për ndryshimet në sistemin e thesarit në kohë reale; dhe me Komisionin për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik (KOMQLI), për dakordim të përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së takimeve informuese me qytetarët për t'i njohur me të drejtën e qasjes së lirë tek informacionet me karakter publik.

Në suazat e prioritet për përparim të nivelit të transparencës fiskale, ESE dorëzoi propozim-përmbajtje për raportin vjetor për punën e Agjencisë së Punësimit, e cila ishte pranuar pjesërisht nga Agjencia dhe është vendosur në raportin për vitin 2018 (vihet re përmirësim mbi mënyrën se si tregohen të dhënat e buxhetit); dorëzoi propozim për përmbajtjen e bazës së hapur për mbajtjen e evidencës në nivel gjashtëmujor mbi statutin e zbatimit të masave dhe shërbimeve për punësim (programore dhe buxhetore) i cili është pranuar nga Agjencia dhe do të shpallet në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 për vitin 2019; është siguruar ndihmë teknike dhe mbështetje financiare për formatin e raportit në lidhje me zbatimin e programit dhe buxhetit të Programit për detektim të hershëm të sëmundjeve malinje për vitin 2018, i cili është shpallur në faqen e internetit të MSH-së; dhe janë dhënë propozime për përparimin e bazës elektronike të Ministrisë së Financave për shpalljen e informacioneve në lidhje me ndryshimet në sistemin e thesarit në kohë reale.

Në drejtim të ngritjes së vetëdijes midis publikut më të gjerë mbi rëndësinë e transparencës fiskale dhe nevojën për zmadhim të nivelit ekzistues të transparencës në institucionet publike, është zbatuar fushatë në media në *Fejsbuk*, me këto parametra statistikore për periudhë prej gjashtë muajsh: informacionet kanë mbërritur te 41 055 profile të përdoruesve të *Fejsbukut*; 1 069 interaksione dhe 53 940 pëlqime. Përveç kësaj, në bashkëpunim me KOMQLI-në, kurse në drejtim të njohjes së qytetarëve me të drejtën e tyre për qasje tek informacionet me karakter publik, janë mbajtur nëntë takime informuese-edukative me qytetarë nga Sveti Nikolla, Shuto Orizari (dy takime), Vinica, Dellçeva, fsh. Cërnik, Tetova, Strumica dhe nga Manastiri.

**Shoqata HOPS – Opsione për Jetë të Shëndetshme Shkup (HOPS)** punon mbi përparimin e të drejtave shëndetësore të bashkësive të margjinalizuara, me fokus të veçantë te personat që përdorin droga, të miturit që përdorin substanca psikoaktive dhe punëtorët seksualë. Në vitin 2019, përveç sigurimit të shërbimeve të domosdoshme, *HOPS*, vazhdoi me aktivitetet për përfaqësim për zgjidhje sistematike përkatëse në politikat, të cilat janë me rëndësi të veçantë për grupet qëllimore. Gjithashtu, *HOPS* mori pjesë në grupet e punës për: reforma të ligjeve me të cilat dënohet puna seksuale; miratimin e ligjit për rregullimin e punës seksuale, me qëllim që të mundësohet mjedis i sigurt pune; përmirësimin e pozitës ekonomike, sociale dhe shëndetësore të punëtorëve seksualë; reformat në politikat për drogat dhe miratimin e Ligjit për kontroll të drogave dhe substancave psikotrope dhe ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, me qëllim që të krijohen politika humane për drogat; dhe përpilimin e Protokollit për veprim me fëmijët nga rruga, Planit aksionar për pako minimale të shërbimeve për shëndetin seksual dhe riprodhues në gjendje krize dhe të jashtëzakonshme për periudhën 2019-2022, Strategjisë nacionale për droga, Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna mbi gratë, duke përfshirë edhe dhunën familjare, Programit gjithëpërfshirës për mjekim, rehabilitim dhe risocializim të të miturve që përdorin substanca psikoaktive, rehabilitim të të dënuarve me kusht, mbrojtjen shëndetësore në burgje etj.

Në suazat e aktiviteteve për përfaqësim për politikat të cilat e përparojnë statusin e grupeve qëllimore, *HOPS* miratoi propozim-iniciativë për përfshirjen në Programin vjetor të punës së Qeverisë për vitin 2020, që lidhet me prezantimin e fitimeve ekonomike dhe përparimin e të drejtave të njeriut nga krijimi i politikave të cilat do të mundësojnë dekriminalizim të punës seksuale në shtetin tonë. Ky propozim-iniciativë parashikon ndryshime në nenin 191 të Kodit Penal dhe në nenin 20 të Ligjit për shkelje të rendit dhe qetësisë publike ose miratimin e një kornize të re ligjore, e cila do të krijojë kushte të sigurta për punën e bashkësisë, promovimin dhe përparimin e statusit social dhe të mirëqenies ekonomike, përmirësimin e shëndetit, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, zvogëlimin e dëmeve nga kjo punë. Pas përgjigjeve pozitive nga MPB-ja dhe MD-ja, u vendos që një përfaqësues i *HOPS* të përfshihet në grupin e punës i cili do të përpunojë ndryshimet në Kodin penal për dekriminalizim të punës seksuale.

Me qëllim që të organizohen më mirë aktivitetet gjatë punës me fëmijë nga mosha 5 deri në 15 vjet, të cilët jetojnë në shtëpi të vogla grupi, në vitin 2019 HOPS në partneritet me MPPS-në organizoi një seri prej 19 trajnimesh për përforcim të kapaciteteve dhe shkathtësive të personave ekspertë që punojnë në institucionet e decentralizuara. Në këto trajnime, të punësuarit në MPPS janë njohur me përmbajtjen e "Udhëzuesit për zbatim të punëtorive me fëmijë në shtëpi të vogla në grup", që përmban 19 module/koncepte të ndryshme për organizim dhe strukturim të aktiviteteve për punën me fëmijët. Pritet në vitin 2020 Udhëzuesi të pranohet nga MPPS-ja dhe të fillohet të zbatohet.

Gjatë vitit 2019, nëpërmjet punës së vazhdueshme në terren në lokacionet kryesore në Shkup<sup>40</sup>, ekipet e HOPS-it kanë kontaktuar gjithsej 3 267 përdorues të drogës, prej të cilëve 43 janë të mitur (26 meshkuj dhe 17 vajza). 10 prej tyre janë fëmijë të rinj në moshë nga 10 deri në 18 që përdorin ekstaza, marihuanë, amfetaminë dhe substanca të tjera psikoaktive, prej të cilëve pesë janë fëmijë që kanë filluar me tretman për shërim nga kjo varësi, kurse tre fëmijë kanë vijuar sesione terapeutike te psikologu dhe psikiatri në HOPS.

Ekipet juridike profesionale të HOPS-it u siguruan 1341 shërbime juridike gjithsej 126 personave të ndryshëm të cilët përdorin droga (109 meshkuj dhe 17 femra), prej të cilëve 49 janë përdorues që i përkasin bashkësisë rome. Janë dhënë informacione juridike dhe këshilla lidhur me shërbimet sociale, marrjen e sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore, marrjen e ndihmës sociale të llojit të ndryshëm, nxjerrjen e dokumenteve personale, strehimin në strehimore, mundësitë dhe modelet për mjekim nga varësitë, zvogëlimin e dëmeve nga përdorimi i drogave, si dhe ndihmë minimale nëpërmjet dhënies së ushqimit, veshjeve dhe mjeteve higjienike. Në vitin 2019 si të drejtat e shkelura më shpesh janë konstatuar: e drejta e mbrojtjes shëndetësore; e drejta e mjekimit; e drejta e lëvizjes së lirë dhe drejta e gjykimit të ndershëm, kurse janë evidentuar edhe raste të diskriminimit për shkak të varësisë, si edhe torturë, sjellje degraduese dhe johumane. Për tetë persona të cilët përdorin drogë është siguruar ndihmë juridike dhe përfaqësim para institucioneve kompetente vendase dhe të huaja, ku dy personave u është dhënë ndihmë juridike për shkak të posedimit të substancave psikoaktive për përdorim personal, në një rast është siguruar ndihmë juridike për dhunë mbi fëmijë që përdor drogë. Janë dërguar dy aplikime në GJEDNJ për dy procedura ku është shkelur e drejta privatësisë së pacientit: njëra procedurë lidhet me dhënien e të dhënave MPB-së nga qendra e metadonit në Spitalin e Përgjithshëm në Strumicë, kurse tjetra lidhet me keqpërdorimin e përcaktuar të ADN-së së një personi i cili përdor drogë. Njëkohësisht është siguruar përfaqësim gjyqësor për 12 punëtores seksuale dhe një anëtar të familjes së punëtores seksuale që ka vdekur, për shkelje të të drejtave gjatë aksionit policor në nëntor të vitit 2008. Për këtë rast është dërguar aplikim dhe pritët

---

<sup>40</sup>Parku i gruas, Katedralja qendrore, Qendra tregtare e qytetit, Tregu i gjelbër, Parku i qytetit dhe Stacioni hekurudhor

vendim nga GJEDNJ-ja, kurse ndihmë juridike dhe përfaqësim janë siguruar edhe për një punëtoresh seksuale, e cila është akuzuar pa bazë për tregti me fëmijë.

Ekipet profesionale në Qendrën Ditore për Mbështetje të Punëtorëve Seksualë dhe Familjeve të Tyre kanë siguruar 771 shërbime juridike. Janë kontaktuar 63 klientë të ndryshëm (53 gra dhe 10 burra), prej të cilëve 45 janë përfaqësues të popullatës rome. Shërbimet më të shpeshta (254 shërbime) për 142 punëtorë seksualë gjithsej janë në fushën e të drejtës së familjes, kurse për 34 persona është siguruar ndihmë e vazhdueshme psikike-sociale.

Në drejtim të përforcimit juridik, në Qendrën Ditore për Mbështetje të Punëtorëve Seksualë dhe Familjeve të Tyre janë realizuar 29 punëtori edukative për 55 anëtare të bashkësisë. Temat<sup>41</sup> që janë përfshirë me këto trajnime më shpesh përkufizohen nga vetë bashkësia, në bashkëpunim me këshilltaren juridike nga HOPS dhe inspektoren nga Sektori për Kontroll të Brendshëm në MPB.

Me qëllim që të përforcohen kapacitetet e bashkësisë së punëtorëve seksualë, HOPS organizoi punëtori për shfrytëzimin e mjeteve dhe qasjeve kreative (video, teatër, fotografi dhe muzikë) në vendosjen dhe krijimin e politikave publike që janë me interes për bashkësinë, përparimin e shkathtësive për komunikim me mediat, përforcimin e vetëbesimit dhe përparimin e shkathtësive për të folur në publik.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të punëtorëve seksualë, HOPS organizoi eveniment donatorësh<sup>42</sup> me qëllim që të mblidhen mjete për edukim të vazhduar të punëtoreshve seksuale për mbrojtje nga dhuna dhe për ngritjen e vetëdijes publike mbi nevojën e përparimit të të drejtave të grupeve të marginalizuara.<sup>43</sup>

Nëpërmjet vizitave në terren në Shkup, Ohër, Strugë, Strumicë dhe Gostivar, një ekip prej tetë parajuristësh bënë 716 kontakte gjithsej, duke ofruar shërbime parajuridike për gjithsej 170 klientë të ndryshëm, 16 prej të cilëve ishin kontakte të reja. Në vitin 2019, janë ofruar gjithsej 224 shërbime për komunitetin e punonjësve të seksit, nga të cilat 82 janë shoqëruar dhe 142 janë drejtuar në institucionet ose organizatat relevante. Si problemet më të zakonshme shfaqen çështjet me të drejtën e familjes, dhunën në familje, dhunën psikologjike nga klientët ose policia, kujdesin shëndetësor, ndihmën sociale, ndryshimin e vendbanimit dhe nxjerrjen e dokumenteve personale.

---

<sup>41</sup> Diskriminimi i punëtorëve seksualë, aktivizmi qytetar, llojet e drogave dhe mjekimi, mënyrat e lidhjeve partnere, tregtia me njerëz, vetëndihma gjatë stresit, mbrojtja nga dhuna familjare, mbrojtja sociale dhe shëndetësore etj.

<sup>42</sup> 1 qershor 2019, lokacioni BackYard, Shkup, u organizua turnir në futboll të vogël, shitje e veprave artistike të punuara nga anëtarët e bashkësive, punëtori kreative për fëmijët për përpunim të bluzave dhe rrëfimi personal i treguar i Kler MekFarlan, viktimë e dhunës dhe aktiviste për luftë kundër të gjitha formave të dhunës mbi gratë.

<sup>43</sup> Janë organizuar 16 punëtori edukative për punëtoresh seksuale.

Me qëllim që të përparohet cilësia e shërbimeve për zvogëlim të dëmeve nga përdorimi i drogave, në vitin 2019 HOPS, vazhdoi me aktivitetet për ndjekjen e të hyrave dhe të dalave në buxhetin e MSH-së në raport me mjetet e marr nga akcizat nga shitja e etil alkoolit, duhanit dhe birrës. Në partneritet me Shoqatën ESE, është përgatitur analizë mbi mundësitë për vetëqëndrim dhe financim të programeve për varësi, të cilat i zbatojnë organizatat qytetare, nga akcizat e dhëna nga shitja e etil alkoolit, birrës dhe cigareve<sup>44</sup>. Është bërë analizë e cilësisë së programeve për mjekim nga varësitë<sup>45</sup>, në bazë të së cilës janë përgatitur rekomandimet për përparim të politikave shëndetësore dhe praktikave të vendosura për zvogëlim të dëmeve nga përdorimi i drogave.

Një pjesë e aktiviteteve për përfaqësim në nivel lokal përfshinë mbajtjen e punëtorisë dyditore për përfaqësuesit e gjashtë vetëqeverisjeve lokale<sup>46</sup>. Si rezultat i këtij aktiviteti, HOPS së bashku me Komunën Kisella Voda dhe Komunën Qendër, aplikoi në thirrjen e MPPS-së dhe Bankës Botërore për hapjen e programit për risocializim të përdoruesve të drogës. Përveç kësaj, në partneritet me "Opcija" nga Ohri dhe Komunën Ohër, HOPS punoi në krijimin e strategjisë lokale për zvogëlim të dëmeve, kurse në partneritet me Komunën e Strumicës është përpiluar "Strategjia lokale për HIV për periudhën 2020-2025" ku parashikohet edhe mbështetje financiare nga buxheti lokal për aktivitetet për zvogëlim të dëmeve dhe për financim të organizatave qytetare që punojnë mbi këtë problematikë.

Nga fundi i vitit 2019 është organizuar shkolla e nëntë për "Droga, politika dhe praktika" e cila ofron qasje shumëdisiplinore në edukimin e 18 kuadrove profesionistë të rinj për punën në fushën e varësive nga droga, me fokus të veçantë në modelet e politikave për drogat, trajtimet e bazuara në fakte, zvogëlimin e dëmeve nga përdorimi i drogave, programet psikosociale, si dhe lidhjen e konceptit të të drejtave të njeriut dhe aspekteve gjinore gjatë zhvillimit të politikave për zvogëlim të dëmeve.

**Koalicioni Margjina**, si përfaqësues i një grupi shoqatash<sup>47</sup> të cilat punojnë me grupe të ndryshme të bashkësive të margjinalizuara, punon mbi promovimin, përfaqësimin, mbrojtjen dhe kujdesin për të drejtat e njeriut të bashkësive të margjinalizuara, në drejtim të realizimit të qasjes së barabartë të shërbimeve shëndetësore, sociale dhe juridike dhe përfshirjen e tyre në të gjitha proceset e jetës shoqërore, nëpërmjet sigurimit të mjedisit mbështetës ku respektohet barazia, liria dhe dallimet.

Në vitin 2019 *Koalicioni Margjinat* ishte aktiv në shumë procese të përfaqësimit të rëndësishme për përparimin e statusit dhe mirëqenies së përfaqësuesve të grupeve të

---

<sup>44</sup>Gjendet në: <https://hops.org.mk/wp-content/uploads/2019/08/HOPS-AKCIZI-FINAL-ZA-web.pdf>

<sup>45</sup>Gjendet në: <https://hops.org.mk/wp-content/uploads/2019/06/KVALITETOT-NA-PROGRAMITE-ZA-LEKUVANE-NA-ZAVISNOSTI-VO-MAKEDONIJA.pdf>

<sup>46</sup>Shkup, Kisella Vodë, Ohër, Kavadarci, Strumicë dhe Gostivar

<sup>47</sup> Nga viti 2011, *Koalicioni Margjinat* është regjistruar si entitet i pavarur, përkatësisht organizatë joqeveritare themelues të të cilit janë HOPS – Opsione për Jetë të Shëndetshme Shkup, HERA – Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Hulumtim, Zgjedhje – Strumicë, EGAL dhe STAR-STAR.

ndryshme të marginalizuara. Përveç rolit kryesor në procesin e miratimit të ligjit të ri, Ligjit për parandalim dhe mbrojtje të diskriminimi, përfaqësuesit e *Koalicionit Margjimat* kanë rolin mbartës dhe në përfaqësimin e ndryshimeve në disa ligje, siç janë ndryshimet në Ligjin për ndërprerje të shtatzënisë; ndryshimet në Ligjin për evidencën amë, dhe dorëzimin dhe miratimin e amendamenteve në bashkëpunim me Grupin Interparlamentar Ndërpartiak për LGBTI në ligjin e ri, Ligjin për arsimin fillor. Me dispozitat e reja të cilat do të miratohen për mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna në arsimin fillor, ligji i ri për arsimin fillor është përmirësuar theksueshëm. Përveç kësaj, Ministria e Arsimit dhe Shkencës filloi procedurë për krijimin e aktit nënligjor i cili do të shërbejë për përcaktimin dhe krijimin e mekanizmave për ballafaqim dhe paraqitje të çdo lloj dhune në shkollat fillore.

Si rezultat i përpjekjeve shumëvjeçare për krijimin e procesit arsimor pa përmbajtje diskriminuese ndaj bashkësive të marginalizuara, është nënshkruar Memorandum për bashkëpunim me BZHA-në për detektim dhe ndryshim të librave shkollorë me përmbajtje diskriminuese në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Deri më tani janë tërhequr pesë libra shkollorë për shkollën fillore dhe gjashtë libra shkollorë për arsimin e mesëm. Filloi procesi i revizionit të tërësishëm, i cili përfshin bashkëpunim edhe me Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokatin e Popullit, MASH-in, Shërbimin Pedagogjik në MASH dhe me UKEM.

Si anëtar i Grupit Interresor për Mundësi të Barabarta, *Koalicioni Margjimat* inicio përfundim për gjuhën seksuale të urrejtjes dhe për përmbajtjet diskriminuese të përmbajtjeve në librat shkollorë.

Mandej, në kontekst të promovimit dhe përparimit të të drejtave të bashkësive të marginalizuara, *Koalicioni Margjimat* e vazhdoi bashkëpunimin me institucionet relevante, me qëllim që të përforcohen kapacitetet e nëpunësve shtetërorë për punën me përfaqësuesit e bashkësive të marginalizuara. Me qëllim që të krijohen mjedise shkollorë të sigurt për bashkësitë e marginalizuara, kurse në bashkëpunim me Aktivin e Shërbimeve Profesionale në arsimin e mesëm, Qyteti Shkup dhe shkollat e mesme të Shkupit, *Koalicioni Margjimat* punon në përforcimin e kapaciteteve në shkollat e mesme për ballafaqim me dhunën e bazuar në gjini dhe bulingun.

Në Partneritet me Entin për Aktivitete Sociale (institucioni i obliguar për licencimin e punëtorëve profesionalë) u zbatua trening-program për zhvillim të vazhdueshëm të personave profesionalë në sistemin e mbrojtjes sociale, sipas Modullit 19 për punë me bashkësitë/grupet e marginalizuara në rrezik. Risi në vitin 2019 është vendosja e një grupi qëllimor në Modul 19, kurse kjo është bashkësia LGBTI (përveç personave që përdorin drogë, punëtorët/punëtorët seksualë dhe personat që jetojnë me HIV). Trajnimin e kaluan 50 persona, të gjithë të punësuar në qendrat për punë sociale në qytete të ndryshme të shtetit (Strumicë, Ohër, Dibër, Shkup, Manastir, Gostivar, Tetovë etj.). Qëllimet e trajnimit lidhen me zhvillimin e ndjeshmërisë për problemet dhe nevojat

e personave që jetojnë me HIV dhe nevojat e bashkësisë LGBTI, zhvillimin e shkathtësive dhe njohurive për punën profesionale me këto bashkësi të marginalizuara, si dhe nxitja e koordinimit më të madh midis institucioneve të cilat veprojnë në rolin e shërbimeve për mbështetje dhe mbrojtje të bashkësive të marginalizuara.

Dhoma e Mjekëve e akreditoi programin për trajnim të mjekëve për punë me personat me HIV dhe trans-bashkësinë. Trajnimi, në përputhje me akreditimin, u jep 12,5 pikë mjekëve ligjërues dhe 9 pikë pjesëmarrësve. Në partneritet me Asociacionin Nacional të Mjekëve Privatë në Maqedoni, u mbajtën dy trajnime me mjekët privatë amë dhe me disa specialistë (gjinekologë), gjithsej 31, nga shumë qytete në shtet. Trajnimi i parë lidhej me nevojat shëndetësore të personave trans, kurse i dyti me nevojën për qasje multidisiplinore në dhënien e shërbimeve shëndetësore personave që jetojnë me HIV. Qëllimi i trajnimeve ishte zhvillimi i ndjeshmërisë të mjekët dhe trajnimi i tyre mbi aspektet e ndryshme të nevojave shëndetësore të personave transgjitorë, por edhe trajnim në përputhje me njohuritë më të reja mjekësore dhe shkencore lidhur me infeksionin HIV, nevojat e personave të cilët jetojnë me HIV dhe shkeljet më të shpeshta të të drejtave të tyre në suazat e sistemit shëndetësor. Mandej, lista e mjekëve është listë relevante për mjekët të cilët mund të ofrojnë mjedis të sigurt për personat trans dhe u jepet personave të bashkësisë trans nga qytetet e ndryshme.

Në periudhën nga prilli deri në dhjetor të vitit 2019 *Koalicioni Margjinat* në bashkëpunim me Aktivin e Shërbimeve Profesionale, mbajti dy seri trajnimesh për bashkëpunëtorët profesionalë dhe për arsimtarët në shkollat e mesme nga Shkupi, Kumanova dhe Velesi mbi temën për dhunën e bazuar në gjini dhe bulingun. Janë trajnuar gjithsej 28 bashkëpunëtorë profesionalë dhe arsimtarë nga 11 shkolla të mesme<sup>48</sup>. Temat e përpunuara janë nga fusha e gjinisë dhe normat gjinore dhe barazia/pabarazia, ndikimi i tyre mbi shëndetin mendor dhe mbi jetën e të rinjve, si dhe dhuna e bazuar në gjini dhe prania e saj në mjedisin shkollor. Qëllimi ishte të zhvillohen shkathtësi për të njohur ndikimin e sistemit heteronormativ mbi zhvillimin e të rinjve dhe një sistem mbrojtjeje nga dhuna e bazuar në gjini në shkolla. Pas vlerësimit që e bëri Aktivi i Shërbimeve Profesionale, kuadri i trajnuar i bashkëpunëtorëve profesionalë dhe arsimtarëve tregoi aftësi të përmirësuara për njohjen, parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore. Trajnimet bazohen në udhëzuesin "E drejta për një shkollë me ndjeshmëri gjinore / Parandalimi dhe intervenimi i hershëm i dhunës së bazuar në gjini në shkolla - udhëzues për arsimtarët dhe shërbimet profesionale në shkolla", botuar nga Koalicioni Margjinat në vitin 2018.

---

<sup>48</sup>SHMK "Jovçe Tesliçkov" – Veles, SHMKP "Dimitrija Çupovski"-Veles; SHMK Gjinnazi "Goce Dellçev" – Kumanovë; SHMK "Pero Nakov" – Kumanovë; SHMQSH "Vëllezërit Milladinovci" – Shkup; SHMQSH Gjinnazi "Zef Lush Marku" – Shkup; QSHN "Zdravko Cvetkovski" – Shkup; SHMMQSH "Dr. Pançe Karagjozov" – Shkup; SHMQSH "Pançe Arsovski" – Shkup; SHSHQ "Shën. Naumi i Ohrit" – Shkup dhe SHMQSH "Vllado Tasevski"- Shkup.



Gjatë vitit 2019 *Koalicioni Margjinat* vazhdoi me sigurimin e ndihmës juridike dhe dokumentimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut ndaj përfaqësuesve të bashkësive të marginalizuara. Para gjykatave u përfaqësuan: dy gra-trans në procedurën kundër mediave; dy gra-trans para prokurorisë, për shkak të shkeljes së të drejtave nga policia; gjashtë persona-trans të përfaqësuar në faza të ndryshme të procedurës administrative dhe procedurës para Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative; një person trans është përfaqësuar para GJEDNJ-së dhe katër përdorues të drogave të përfaqësuar në dy procedura para GJEDNJ-së. Përveç rastit "G" përkatësisht rastit të personit Iks kundër Maqedonisë, ku aktvendimi është në dobi të personit Iks, të cilin e përfaqësonte *Koalicioni Margjinat*, rastet e tjera janë ende në vijim.

Në vitin 2019 janë dokumentuar 174 raste të shkeljeve të të drejtave të bashkësive të marginalizuara. Në pjesën më të madhe viktimat kanë qenë meshkuj gej dhe gra transgjimore, mandej punëtorë seksualë, njerëz që përdorin drogë dhe disa raste të shkeljes së të drejtave të meshkujve transgjimorë. Rastet dokumentohen nga vetë viktimat, parajuristët dhe punëtorët në terren nga organizatat partnere dhe anëtare e *Koalicionit Margjinat*. Një pjesë e madhe e viktimave i dokumentojnë vetë rastet, kërkojnë këshillim juridik ose lidhje me ndonjë lloj tjetër shërbimesh (mbështetje psikosociale, shërbime shëndetësore ose shërbime nga fusha e mbrojtjes sociale). Sfidë kryesore ende mbetet mungesa e vullnetit për të paraqitur rastin tek institucionet kompetente, sidomos kur bëhet fjalë për dhunë që ndodh në kontekstin që lidhet me punën seksuale apo dhunën lidhur me orientimin seksual.

U realizuar dy trajnime për dokumentim të rasteve me njerëzit që jetojnë me HIV dhe me njerëzit LGBTI. U mbajtën edhe dy takime në Gostivar dhe në Strumicë për këshillim juridik për raste konkrete të shkeljes së të drejtave dhe njohjen e bashkësive qëllimore me mundësinë për dokumentim të rasteve, marrjen e ndihmës juridike dhe këshillimit psikik-social. Me këto takime janë përfshirë 12 persona, kurse me trajnimet për dokumentim janë përfshirë 11 persona.

Në lidhje me gjuhën e urrejtjes në mediat dhe mediat sociale, është regjistruar zmadhim i gjuhës së urrejtjes ndaj njerëzve LGBTI në periudhën e mbajtjes së "Paradës së Krenarisë". Me qëllim që të testohen mekanizmat mbrojtëse, një pjesë e komenteve me gjuhë të urrejtjes janë paraqitur në sektorin e krimit kompjuterik në MPB, por për asnjë paraqitje nuk është kthyer përgjigje. Një rast i gjuhës së urrejtjes ndaj njerëzve LGBTI nga në internet-portal është paraqitur te Këshilli për Etikë i Mediave, ku ankesa është miratuar. Te Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokati i Popullit dhe Oda e Farmacistëve janë paraqitur tri raste të diskriminimit ndaj njerëzve LGBTI. Në të gjitha rastet organet kompetente konstatuan diskriminim, kurse për një rast nuk ka ende përgjigje nga Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Në lidhje me shkeljen e të drejtave nga policia, janë iniciuar katër procedura të shkeljes së të drejtave në procedurë policore, trajtim diskriminues, keqtrajtim në kryerjen e detyrës dhe shqetësim të punëtorëve seksualë, njerëzve që përdorin droga dhe LGBTI. Për një rast nuk ka përgjigje, në dy raste nuk është përcaktuar shkelje, kurse në një rast ka filluar procedura disiplinore kundër një nëpunësi policor.

Në një rast të dhunës familjare ndaj një vajze transgjimore ka filluar procedura në Qendrën për Punë Sociale, kurse pastaj edhe ankesa për veprim të punonjësve sociale. Si rezultat i procedurës, shërbimet sociale realizuan disa këshillime me familje, kurse dhuna familjare është ndërprerë.

Sfidat kryesore janë mungesa e kapaciteteve të institucioneve për njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të bashkësive të marginalizuara, kurse në lidhje me veprimin policor, mosfunksionimi i sistemit për kontroll mbi policinë, mungesa e vullnetit politik për dënim të nëpunësve policorë dhe mosmarrja e përgjegjësisë për veprimin.

Me mbështetje të Programit për shëndetin publik në Fondacionet e Shoqërisë së Hapur i është dhënë grant **Shoqatës për Mbështetje të Punëtorëve të Margjinalizuar STAR-STAR** (STAR-STAR). Përveç aktiviteteve për ndërtim të kapaciteteve për punëtorët seksualë për vetëpërfaqësim për përmirësim të statusit social-ekonomik dhe shëndetësor, shpërndarja e botimeve elektronike mujore të revistës "S-Work" dhe aktivitetet e linjës informative për mbështetje onlajn (në vitin 2019), STAR-STAR ishte veçanërisht aktiv në përfshirjen e bashkësisë në proceset e parandalimit të HIV-it. Pas procesit konsultues të zbatuar me bashkësinë e punëtorëve seksualë, në lidhje me barrierat kryesore të përdorimit të PrEP-profilaksës<sup>49</sup> në tri rajone (STAR – Central Shkup, STAR –Perëndim Gostivar dhe STAR – Lindje Strumicë) STAR-STAR mori pjesë në krijimin e Protokollit nacional për PrEP dhe PEP-profilaksë, që është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Me rëndësi të veçantë dhe si vërtetim për suksesin në punë është edhe shpërblimi ndërkombëtar<sup>50</sup> nga Platforma për aksion pozitiv, të cilin e mori STAR-STAR në vitin 2019. Marshi i sivjetshëm i punëtorëve seksualë i përkushtohej tematikisht dhunës së bazuar në gjini mbi punëtorët seksualë.

## **NDRYSHIMI I NARRACIONEVE NEGATIVE NDAJ ROMËVE**

Nëpërmjet Programit për shëndet publik në Fondacionet Shoqëria e Hapur, FSHHM-ja siguroi mbështetje për organizata qytetare për projekte nëpërmjet të cilave punohet mbi ndryshimin e narracioneve negative ndaj romëve në institucionet shëndetësore publike.

Ekipi i [Vidi Vaka](#) krijoi pesëmbëdhjetë video, tri lajme grafike dhe tri video-intervista të cilat tregohen në mediat sociale dhe arritën 18 524 shikime gjithsej. Përveç kësaj

<sup>49</sup>Përdorimi preventiv i medikamenteve për mbrojtje para veprimit që çon në rrezikim nga infeksioni HIV

<sup>50</sup><https://bit.ly/3atQD3G>

studentët e Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin “Shën. Kirili dhe Metodij” – Shkup morën pjesë në debatin publik dhe projeksionin e video-produkteve më të para lidhur me narracionet për romët në institucionet shëndetësore.

**Shoqata Teatër Roma - Shkup**, e shfrytëzoi fuqinë e formës teatrale si mjet për ndikim mbi narracionet ndaj romëve. Shfaqja teatrale “Labirint”<sup>51</sup>, që u mbajt më 2 dhjetor 2019 në Operën dhe Baletin Nacional në Shkup, dhe ku morën pjesë 450 persona, dërgoi mesazhe të qarta mbi nevojën për ndryshim të perceptimeve dhe komunikimit të punonjësve shëndetësorë, si dhe mbi ngritjen e vetëdijes për nevojën e mundësimit të trajtimit të barabartë në realizimin e shërbimeve shëndetësore pa paragjykime dhe pa diskriminim.

Me qëllim që të përparohen kompetencat kulturore dhe strukturore të punonjësve shëndetësorë, ekipi i profesorëve universitarë <sup>52</sup>, në bashkëpunim me **Shoqatën e Internistëve**, vazhdoi me aktivitetet e vitit të kaluar. Në suazat e edukimit të vazhdueshëm të mjekëve janë realizuar katër punëtori të akredituara për 100 punonjës shëndetësorë në Shtip, Veles, Strumicë dhe në Prilep. Përveç kësaj, në Berovë u mbajt shkolla verore për 25 studentë, punonjës të ardhshëm shëndetësorë.

Në suazat e programeve studimore për nxënësit e mjekësisë së përgjithshme dhe të studimeve të tjera trevjeçare profesionale mjekësore, si dhe në studimet pasuniversitare dhe të doktoraturës për shëndetin publik, vazhduan ligjërimet për lëndën zgjedhore të akredituar *Kompetencat kulturore dhe strukturore për punonjësit shëndetësorë*.

---

<sup>51</sup> Gjendet në: <https://www.youtube.com/watch?v=LBaZCXhwY20>

<sup>52</sup> Prof. dr. Elena Qosevska, prof.dr. Vesna Veliq Stefnovska dhe prof.dr. Lubica Georgievska Ismail.

## LISTA E PROJEKTEVE DHE GRANTISTËVE TË MBËSHTETUR NË VITIN 2019

<b>Pjesëmarrja e shoqërisë qytetare në procesin e aderimit në BE</b>		
<b>GRANTIST</b>	<b>QËLLIMI</b>	<b>SHUMA E GRANTIT NË USD</b>
EVROTINK – Qendra për Strategji Evropiane Shkup 3a	Qytetarët për reforma evropiane	\$60.000,00
Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve “Të gjithë për gjykim të drejtë” Shkup	Për drejtësi – Ndjekja e zbatimit të Strategjisë për reforma në gjyqësor	\$44.940,00
Koalicioni të Drejta Shëndetësore dhe Seksuale të Grupeve të Margjinalizuara MARGJINA, Shkup	LPD nën Ilupë: Ndjekja e zbatimit të Ligjit të ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi	\$45.000,00
Instituti për Demokraci “Societas Civilis”, Shkup	Monitorimi i suksesit të punës së Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit	\$38.389,00
Finance Think – Instituti për Hulumtim dhe Politika Ekonomike, Shkup	Barazia gjinore në vendin e punës: Monitorimi në nivel lokal	\$6.915,00
Kontrapunkt, Shkup	EU REKA	\$6.970,00
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shkup	Ndikimi i Kapitullit 23 mbi procesin e aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian	\$6.948,00
Shoqata e Qytetarëve të Punëtorëve Tekstilistë, Lëkurëpunues dhe Këpucarëve “Tekstilisti i Zëshëm”, Shtip	Qasja te drejtësia në Rajonin Lindor	\$6.803,00
Shoqata për Edukim të Bujqve “Bursa e Gjelbër”, Manastir	Nga gruaja rurale deri te sipërmarrësi i suksesshëm, pa stereotipa dhe diskriminim	\$7.000,00

Koalicioni rural, Kumanovë	Të drejtat fundamentale të njeriut dhe barazia gjinore – sfidë për praktikum në mjediset rurale	\$7.000,00
Shoqata për Demokraci Lokale Qendra e Bashkësisë së Komunës Strugë, Strugë	Analiza e perceptimit publik për procesin e aderimit në BE – me fokus në Kapitulli 23	\$6.969,00
Qendra Informative Afariste Rome në Maqedoni, Shkup	Respektimi i të drejtave të të burgosurve nga bashkësitë etnike nëpër prizmin e bashkësisë rome	\$6.994,00
Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve “Të gjithë për gjykim të drejtë” Shkup	Masa Paraburgim midis praktikës vendase dhe evropiane	\$7.000,00
Shoqata e Qytetarëve Media Plus, Shtip	Edhe informimi lokal është test për BE-në	\$6.920,00
Shoqata për Hulumtime, Analiza dhe Zhvillim “Llupa e Gjelbër”, Shkup	Risocializimi dhe riintegrimi në shoqëri nëpërmjet provës	\$6.690,00
Shoqata për të Drejta dhe Mundësi të Barabarta “Gratë në ekonomi”, Shtip	Ji e guximshme, fol fuqishëm!	\$6.811,31
Shoqata për Zhvillim Rural, Grupi Aksionar Agro Lider, Krivogashtani	BE skepticizëm përkundrejt BE optimizëm në mjediset rurale	\$6.840,00
Multikultura, Tetovë	Të rinjtë janë ndryshimi për aderim në Bashkimin Evropian	\$6.819,00
Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, Shkup	Drejhtësia Administrative sipas standardeve evropiane	\$6.990,00
Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve “Të gjithë për gjykim të drejtë”, Shkup	Monitorimi sistematik i procedurave penale gjyqësore	\$30.000,00
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>\$321.998,31</b>

### Aleanca qytetare për transparencë: Monitorimi i procesit të reformës së administratës publike nga organizatat qytetare

GRANTIST	QËLLIMI	SHUMA E GRANTIT NË USD
Finance Think – Instituti për Hulumtim dhe Politika Ekonomike, Shkup	360 Monitorim i sigurimit të shërbimeve sociale në nivel lokal: Përvoja nga komunat e Prilepit dhe Dollnenit	\$10.719,33
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>\$10.719,33</b>

### Deri te shteti i robëruar – nëpërmjet gjyqësorit, prokurorisë dhe policisë

GRANTIST	QËLLIMI	SHUMA E GRANTIT NË USD
Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve “Të gjithë për gjykim të drejtë”, Shkup	Deri te “shteti i robëruar” në Maqedoninë e Veriut – gjyqësori, prokuroria, policia	\$9.700,00
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shkup	Deri te “shteti i robëruar” në Maqedoninë e Veriut – gjyqësori, prokuroria, policia	\$10.500,00
Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shkup	Deri te “shteti i robëruar” në Maqedoninë e Veriut – gjyqësori, prokuroria, policia	\$6.000,00
3G Rrjeti Ballkanik Hulumtues i Reporterëve Shkup, Shkup	Deri te “shteti i robëruar” në Maqedoninë e Veriut – gjyqësori, prokuroria, policia	\$40.290,00
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>\$66.490,00</b>

### Partneritete në bashkësi për përparimin e demokracisë lokale

GRANTIST	QËLLIMI	SHUMA E GRANTIT NË USD
Shoqata Gjeografike Rajonale GEOSFERRA, Manastir	Zgjojeni EKO-VETËDIJEN në VETE	\$5.840,00
Shoqata e Qytetarëve Media Plus, Shtip	Reago në vendin e vërtetë	\$5.685,00
Shoqata e Juristëve Legal Tink, Shtip	Përfshirja e të rinjve në planifikimin e prokurimeve publike	\$5.594,00

Forumi i Grave, Tetovë	Mbrojta sociale e qytetarëve në Komunën e Tetovës	\$6.164,00
Aleanca e Shoqatave për Zhvillim Rural, Rrjeta LAGovi, Krivogashtani	Së bashku për mbrojtjen e mjedisit jetësor	\$5.000,00
Qendra Nazionale Rome, Kumanovë	Përparimi i pjesëmarrjes së romëve në politikat lokale për planifikim urbanistik	\$5.950,00
Lëvizja për Zhvillim të Qëndrueshëm Social-Ekonomik Global, Manastir	Qytetarët ndjekin, krijojnë dhe vendosin për paratë e veta	\$5.750,00
Multikutura, Tetovë	Si shpenzohen paratë e prokurimeve publike të gjimnazistëve	\$6.110,00
Fondacioni për Zhvillim të Bashkësisë Lokale, Shtip	(RI)VIZION i financimit lokal i organizatave qytetare	\$5.400,00
Iniciativa Qytetare e Grave "Klea", Manastir	Gra Aktive në Komunën e Manastirit	\$5.507,00
Denis Ampev	Kre/aksion për zhvillim të demokracisë	\$24.978,00
Mirosllav Stojkovski	Kreativa Manastir	\$25.000,00
Egzona Abdi	Revolucioni i qetë	\$24.770,00
Institucioni Qendra për Arte Bashkëkohore, Shkup	Mbështetje institucionale për tre vjet	\$150.000,00
Kontrapunkt, Shkup	Festivali për kulturë kritike - KRIK	\$3.400,00
Shoqata Iniciativa për Zhvillim Ekonomik të Romëve REDI, Tetovë	Aksion për donacion të mjeteve për familjet e dëmtuara rome në Shqipëri	\$1.100,00
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>\$286.248,00</b>

## Bërthama rajonale kreative: shfrytëzimi i fuqisë së artit dhe së kulturës për të inkurajuar aksion qytetar kundër korrupsionit

GRANTIST	QËLLIMI	SHUMA E GRANTIT NË USD
Zorica Zafirovska	Oksigjen!	\$1.000,00
Igor K. Ilievski	Shkunde gjykatësin	\$1.000,00
Darko Taleski	Parada e korrupsionit	\$1.000,00
Jellmaz Dervishi	Dita e hapur e antikorrupsionit	\$1.000,00
Dragana Gunin Stojçevska	Thuaji JO korrupsionit në fakultete	\$900,00
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>\$4.900,00</b>

## Arsimi i bashkësive më të vogla etnike

GRANTIST	QËLLIMI	SHUMA E GRANTIT NË USD
Fondacioni për Iniciativa Kulturore dhe Arsimore "Hap pas hapi", Shkup	Partneritet strategjik me FSHHM-në në zbatimin e konceptit Arsimi për bashkësitë më të vogla etnike	\$51.000,00
Qendra Informative Afariste Rome në Maqedoni, Shkup	Ndihmësi pedagogjik i nxënësve në shkollat fillore	\$2.200,00
Metamorfozis, Shkup	Resurse të hapura arsimore	\$20.000,00
Qendra Informative Afariste Rome në Maqedoni, Shkup	Ndihmësi pedagogjik i nxënësve në shkollat fillore	\$11.990,00
Shoqata e Drejtorëve "Liderë shkollorë", Shkup	Përforcimi i rjetës së drejtorëve të shkollave në Maqedoninë e Veriut	\$15.000,00
SHFR "Dituria" fsh. Lubin, Saraj	Materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse për mësimdhënie cilësore	\$5.000,00



SHFK "Goce Dellçev", fsh, Vasilevë, Vasilevë	Materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse për mësimdhënie cilësore	\$4.000,00
SHF "Vëllezërit Ramiz dhe Hamid", Shuto Orizari, Shkup	Materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse për mësimdhënie cilësore	\$5.000,00
SHFK "Shën. Kirili dhe Metodij" fsh. Kuçevishtë, Çuçer Sandevë	Materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse për mësimdhënie cilësore	\$4.000,00
SHFK "Mustafa Qemal Atatürk", Koliçan i Poshtëm, Studeniçan	Materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse për mësimdhënie cilësore	\$4.000,00
SHFK "Nexhati Zeqirija", fsh. Koxhaxhik, Qendër Zhupë	Materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse për mësimdhënie cilësore	\$4.000,00
SHFK "Strasho Pinxhur", fsh. Staro Nagoriçan, fsh. Josifovo, Valandovë	Materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse për mësimdhënie cilësore	\$4.000,00
SHFK "Svetozar Markoviq", fsh, Staro Nagoriçan, Staro Nagoriçan	Materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse për mësimdhënie cilësore	\$3.000,00
SHFK "Rajko Zhinzifov" fsh. Gorno Orizari, Veles	Materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse për mësimdhënie cilësore	\$3.000,00
SHFK "Braça Ribar" fsh. Tabanovc, Kumanovë	Materiale didaktike dhe mjete mbikëqyrëse për mësimdhënie cilësore	\$4.000,00
Shoqata për Hulumtime dhe Analiza, ZMAI, Shkup	Metodologjia e rishpërndarjes së mjeteve të komunave deri te shkollat fillore	\$25.000,00
Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shkup	Mbështetja sociale dhe arsimore e fëmijëve të rrugës	\$15.000,00
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>\$180.190,00</b>

<b>Strategjia rrjetë për përforsim juridik</b>		
<b>GRANTIST</b>	<b>QËLLIMI</b>	<b>SHUMA E GRANTIT NË USD</b>
Romano Çaçipe, Shkup	Llogaridhënia sociale dhe përforsimi juridik i bashkësisë rome	\$37.908,00
IZHIB – Iniciativa për Zhvillim dhe Inkluzion të Bashkësive, Shkup	Llogaridhënia sociale dhe përforsimi juridik i bashkësisë rome	\$12.000,00

OJQ KHAM, Dellçevë	Llogaridhënia sociale dhe përforsimi juridik i bashkësisë rome	\$8.000,00
Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE, Shkup	Mbështetja institucionale për ESE	\$50.000,00
Asociacioni për Zhvillim Demokratik të Romëve "Dielli", Tetovë	Ndihma parajuridike për bashkësinë rome në pjesën përfundimtare të RMV-së	\$78.560,00
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shkup	Përforsimi juridik i tekstilisteve për vetëpërfaqësim	\$40.000,00
HERA-Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Hulumtim, Shkup	Përparimi i të drejtave riprodiktive të romeve në Shuto Orizar	\$145.790,00
Shoqata për Edukim Juridik dhe Transparencë Stanica P.E.T., Prilep	Qendra për qasje te drejtësia	\$42.450,00
Shoqata e Punonjësve Arsimorë për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave dhe Fëmijëve – LIL, Shkup	Monitorimi dhe dokumentimi i shkeljes së të drejtave të pacientëve romë	\$46.500,00
Fondacioni CEED Maqedoni, Shkup	Sipërmarrja sociale si mundësi për vetëqëndrueshmëri të organizatave	\$46.330,00
Koalicioni të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara MARGJINA, Shkup	Shndërrimi i Qëllimit 16.3 nga qëllimet globale të OKB-së për zhvillim të qëndrueshëm në nivel nacional	\$55.690,00
Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE, Shkup	Standardizimi dhe qëndrueshmëria e llojeve të ndryshme të ndihmës juridike pa pagesë	\$39.573,00
Izbor, Strumicë	Qasja te drejtësia në Maqedoni	\$14.400,00
Qendra Kulturore Rinore, Manastir	Qasja te drejtësia në Maqedoni	\$18.070,00
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shkup	Qasja te drejtësia në Maqedoni	\$20.700,00
Qendra Nazionale Rome, Kumanovë	Qasja te drejtësia në Maqedoni	\$20.000,00
EHO – Organizata Edukative-Humanitare, Shtip	Qasja te drejtësia në Maqedoni	\$15.146,00

Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE, Shkup	Përmirësimi i qasjes të drejtësia dhe sigurimi i llojeve të ndryshme të ndihmës juridike pa pagesë për të varfrit dhe grupet e lëndueshme	\$30.000,00
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>\$721.117,00</b>

<b>Të drejtat studentore dhe angazhimi</b>		
<b>GRANTIST</b>	<b>QËLLIMI</b>	<b>SHUMA E GRANTIT NË USD</b>
Shoqata e Qytetarëve "Forumi Arsimor Rinor", Shkup	Angazhimi i të rinjve për politikën studentore dhe rinore	\$100.000,00
Media Plus, Fokus SHPKNJ, Shkup	Trajnim praktik i gazetarëve të rinj	\$8.000,00
Sindikata e Pavarur Akademike SPA, Shkup	Transparenca financiare dhe llogaridhënia në arsimin e lartë dhe shkencë në RMV	\$27.535,00
Shoqata Liderë për Edukim, Aktivizëm dhe Zhvillim, Shkup	Parandalimi i ikjes së trurit	\$14.951,00
Këshilli Nacional Rinor i Maqedonisë, Shkup	(Ri)formimi studentor	\$14.982,00
Shoqata e Qytetarëve "Forumi Arsimor Rinor", Shkup	Studentë të angazhuar për konvikte studentore pa korrupsion në Republikën e Maqedonisë së Veriut	\$50.000,00
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>\$215.468,00</b>

<b>Politikat shëndetësore të bazuara në drejtësi</b>		
<b>GRANTIST</b>	<b>QËLLIMI</b>	<b>SHUMA E GRANTIT NË USD</b>
Shoqata e qytetarëve Teatri Roma, Shkup	Ndryshimi i narracioneve për romët në institucionet shëndetësore	\$21.140,00
Fondacioni IDEA, Evropa Juglindore, Shkup	Ndryshimi i narracioneve për romët në institucionet shëndetësore - Rrëfime të Sunait	\$72.000,00
OJQ KHAM Dellçevë, Dellçevë	Sigurimi i mbështetjes teknike dhe mentorimit të organizatave qytetare romë vendase dhe të huaja për shfrytëzimin e metodologjive të llogaridhënies	\$15.000,00

	sociale dhe përforcimit juridik	
Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE, Shkup	Sigurimi i mbështetjes teknike dhe mentorimit të organizatave qytetare vërdase dhe të huaja për shfrytëzimin e metodologjive të llogaridhënies sociale dhe përforcimit juridik	\$43.000,00
Koalicioni të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara MARGJINA, Shkup	Përparimi i të drejtave seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të margjinalizuara	\$141.395,00
HOPS – Opsione për Jetë të Shëndetshme Shkup, Shkup	Përparimi i shëndetit të njerëzve që përdorin drogë nëpërmjet sigurimit të financimit të vazhdueshëm të programeve për zvogëlim të dëmeve nga Buxheti nacional	\$60.000,00
HOPS – Opsione për Jetë të Shëndetshme Shkup, Shkup	Mbështetje institucionale për HOPS	\$182.500,00
Shoqata për Mbështetje të Punëtorëve të Margjinalizuar STAR-STAR, Shkup	Përforcimi i kapaciteteve organizative të STAR-STAR	\$35.000,00
Qendra për Komunikime Qytetare, Shkup	Zvogëlimi i korrupsionit në arsim dhe shëndetësi në nivel lokal	\$15.500,00
Shoqata për edukim juridik dhe transparencë STANICA P.E.T., Prilep	Zvogëlimi i korrupsionit në arsim dhe shëndetësi në nivel lokal	\$10.000,00
Shoqata për Demokraci Lokale Qendra e Bashkësisë së Komunës Strugë, Strugë	Zvogëlimi i korrupsionit në arsim dhe shëndetësi në nivel lokal	\$10.000,00
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>\$605.535,00</b>

**GJITHSEJ PËR GRANTE NË VITIN 2019: \$2.412.665,64**

**Fondacioni Shoqëria e Hapur -  
Maqedoni**

Bul. Jane Sandanski 111,  
p.fax 378, 1000 Skopje  
tel.:+389 2 2444 488  
e-adresa: fosm@fosm.mk



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА  
OPEN ОТВОРЕНО  
SOCIETY ОПШТЕСТВО  
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА